

Në letrat tona tashmë ka ardhur dhe është konsoliduar si pjesë e saj edhe një "letërsi tjetër", ajo e dhembjes së tejme, e dalë nga burgjet dhe internimet, që tregoi të patreguarën, persekutimin e njeriut nga njeriu, ferrin mbi tokë, nga shkaku i sistemit, i ideologjisë sunduese, i mbylljes mizore etj., që tronditi lexuesin dhe shoqërinë në tërësi.

Letërsia e kujtesës, që u dënua, dhe universalja e saj

PËRSIATJE DHE POLEMIKË

nga Visar Zhiti




Portreti nga Ina Lajthia

SË AFËRMI NGA "ONUFRË"

**"METAMORFOZA
E NJË KRYEQYTETI"**

**ROMANI I RI I
SHKRIMTARIT
YLLJET ALIÇKA**

(fq. 5)



Vepër e piktorit A. Morina

SHUMËLLOJSHMËRIA KRIJUESE E MID'HAT FRASHËRIT

Vepra të zgjedhura 3,
Instituti i Studimeve Historike Lumo Skëndo,
Tiranë, 2018

nga Bashkim Kuçuku

FOTOJA HISTORIKE



**1938/ ASDRENI E
LASGUSHI NË SHKODËR
PRITJA MADHËSHTORE
ME BANDË MUZIKORE
DHE FJALIMI PREKËS
I FISHTËS**


Nga Violeta Murati

(Fq. 12)

"Na ishte njëherë shpresa", botohet në Finlandë
antologjia e poezisë bashkëkohore shqiptare (Fq. 10)

"Turist në Utopi", udhëtime në peizazhin
shqiptar të autorit Rune Ottosen (Fq. 13)

Filmi shqiptar "Streha mes reve", shpallet
më i miri në Valletta Film Festival (Fq. 10)



JORGOS SEFERIS, POEZIA E DHIMBJES

nga Romeo Çollaku

(fq. 14)



**ZOTI
ZBRET MBI
JASEMINË**

SHQIPONJA
AXHAMI

BIBLIOTEKË

**PA HERONJ,
PA BUJË**

NDRIÇIM
ADEMAJ



**STEVENSON:
NGA IDETË
E FUNDIT**

Aurel Plasari (fq. 11)

BLOCKNOTE

Në letrat tona tashmë ka ardhur dhe është konsoliduar si pjesë e saj edhe një “letërsi tjetër”, ajo e dhembjes së tejme, e dalë nga burgjet dhe internimet, që tregoi të patreguarën, persekutimin e njeriut nga njeriu, ferrin mbi tokë, nga shkaku i sistemit, i ideologjisë sunduese, i mbylljes mizore etj., që tronditi lexuesin dhe shoqërinë në tërësi.

LETËRSIA E KUJTESËS, QË U DËNUA, DHE UNIVERSALJA E SAJ

PËRSIATJE DHE POLEMIKË

nga Visar Zhiti

NJË KUARTET THËNIESH

1 - *Ne jemi ajo që kujtojmë. Të treguarit është kujtim dhe kujtimi është të jetuarit*, - shkruante një nga poetët më të mëdhenj në Europë, Mario Luzi.

2 - *Më jepni një dhembje, t’ju jap një vepër të madhe*, - duket se po lutet ende kështu, madhërisht, Fjodor Dostojevski, i burgosuri që e dënuan me pushkatim si kundërshtar i Carit, por që u fal po prej tij.

3 - *Gjithçka përreth kërkon kujtesë/ dhe për kujtesë mall veç ka...* - janë dy vargje të Kadarese të një poezie të dikurshme nën diktaturë, që sikur parandienin kanosjen e një harrese të dëmshme.

4 - *Diçka i mungon tokës,/ nga qielli t’i zbrësë./ Diçka edhe qiellit,/ nga toka t’i ngjitet, ka shpresë./ Më bëhet i gjej te vetja/ ç’mungon te gjithësia:/ Qiellit: urrejtja,/ tokës: dashuria*, - poezi e poetit të burgjeve Pano Taçi, që na kumton mungesat e mëdha, që dhe duhet urreyer si në tokë për të dashur më shumë si në Qiell...

Në letrat tona tashmë ka ardhur dhe është konsoliduar si pjesë e saj edhe një “letërsi tjetër”, ajo e dhembjes së tejme, e dalë nga burgjet dhe internimet, që tregoi të patreguarën, persekutimin e njeriut nga njeriu, ferrin mbi tokë, nga shkaku i sistemit, i ideologjisë sunduese, i mbylljes mizore etj., që tronditi lexuesin dhe shoqërinë në tërësi.

Dhe s’kishte si të mos flitej për këtë letërsi, duke u krijuar një opinion kritik, madje e gjithë ecuria e saj, ajo prurje e madhe dhe e beftë, duhej të përcillej me qëndrime të ndryshme, edhe të skajshme, që shpesh u kthyen në përballje.

Do të doja të qëndroj në këtë çështje. Së fundmi, ditë më parë kam ndeshur në konstatimin se letërsia e kujtesës (kupto: letërsia e burgjeve dhe e internimeve, shën. imi) *nuk ka mundur të dalë nga përvoja personale dhe i mungon qasja universale*, – e shprehu një veprimtare e kujtesës, përkthyes dhe autore, Jonila Godole, pedagoge dhe drejtuese ekzekutive e një Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë. Shqetësimin, duke mos e menduar si vetëm të saj, e konsideroj si tregues që, përderisa merren me këtë letërsi, ajo tashmë është dhe pranohet.

Por më vjen të pyes menjëherë, i mungon qasja universale apo e universalizimit? E përvojën personale ta lidhë me përvoja të tjera, të largohet nga vetja?

GJATË ECURISË

Për të arritur deri këtu, vështrimet ndaj kësaj letërsie kanë evoluuar. Do të doja rishikimin e tyre sintetizueshëm, ku

më interesojnë më shumë ato vështrime që kanë pasur brenda goditjen.

Do të doja të pyes pse kjo letërsi quhet kaq thjesht “e kujtesës”?

Në fakt, diktaturat ndihen në armiqësi me kujtesën dhe e luftojnë atë. Ndërsa nga letërsia që, natyrisht, vjen prej kujtesës, kanë frikë dyfish. Libri është kujtesa e botës, sipas Borhesit.

Po a thua ka letërsi të harresës? Nën “kulturën e së keqes” bëhen përpjekje të angazhuara për të harruar ç’nuk u duhet regjimeve dhe për të kujtuar dhunshëm ç’duan ato.

Më është dukur çudi që letërsia që sjell atë jetë, më saktë atë antijetë, në burgjet dhe kampet e internimeve të diktaturës, që tregon dramat e mëdha kur ideologjitë marrin pushtet, dhunën e përbindshme dhe qëndresën mitike për të mbetur njeri edhe në rrethana çnjerëzore, përpjekjet sizifiane për racione lirie etj., veçohet duke u quajtur “letërsi e kujtesës”. E gjithë letërsia e tillë është, ç’lexohet është e së shkuarës, e “muzeut të kujtesës”, dhe shtoj “e kujtesës së të ardhmes”, e ka këtë forcë e magji letërsia.

Ta veçosh këtë si “letërsi të kujtesës”, duke nënkuptuar një nënpjesë të saj, pa fiksion, pra pa “fantazi”, mua më duket sikur e mpakin, gati sikur të thuash se ajo nuk është plotësisht letërsi, ditar apo memuaristikë dhe aq, kurse në të vërtetë kjo letërsi ka në themel të vërtetën dhe më shumë sesa fantazinë e autorit, ka fantazinë e hatashme të realitetit që, sipas Dostojevskit, ia kalon çdo fantazie tjetër.

“Letërsisë së kujtesës” pa një përcaktor tronditës më duket se i shpërndahet misioni, i tretet në një të

përgjithshme të papërcaktuar, i hiqet edhe diçka nga martirizimi dhe terri.

Unë e kam quajtur “letërsi e dënuar” në një studim timin, “Panteoni i nëndheshëm”, botuar vite më parë, duke përfshirë kështu gjithë letërsinë e prodhuar në rrethana të dënuara, veçanërisht burgjeve dhe internimeve, por gjithsesi jo vetëm nga të dënuarit, dhe kam marrë në ndihmë atë që thoshte hebreu-hungarez Imre Kertész, nobelist, i cili ka qenë i mbyllur në kampin e Aushvicit. Kjo, sipas tij, përbën thelbin e krijimtarisë, me matricën se ...*cili autor, në fund të fundit, nuk është shkrimtar i Holokaustit?* Vetë pyetja është edhe përgjigje ndërkaq. *Holokausti është një përvojë universale...* – vazhdon Imre Kertész, - *që nuk ndan, përkundrazi bashkon... Holokausti tani ka krijuar një kulturë, e cila s’mund të mohohet se ka ardhur dhe vjen ende, dhe letërsia e kësaj kulture munda të frymëzojë Shkrimet e Shenjta dhe tragjedinë greke, – dy kolonat e kulturës europiane, – në mënyrë që realiteti i pafalshtëm të mund të lindë faljen ose vetë shpirtin dhe katarsisin... Europa nuk është vetëm treg i përbashkët dhe bashkim doganor, por edhe frymë dhe spiritualitet i përbashkët. Cilido që kërkon të bëhet pjesë e këtij shpirti, duhet të tejkalojë, midis shumë provave, edhe atë të përballimit moral dhe ekzistencial me holokaustin.* (Imre Kertész, *Il secolo infelice*, Bompiani, Milano, 2007, fq. 54, 258, nënvizimet e mia.)

Kjo letërsi e holokaustit/ gulagut/ burgjeve/ internimeve erdhi edhe tek ne. Ortek letrar. Kujtesë dhe ndërgjegjeje. Moral e përgjegjshmëri dhe akuzë e qortim. Art. E rrëmbu lexuesin dhe e çoi atje ku nuk kishte qenë. Por, siç e kam thënë, duke u ndeshur edhe me mosmiratime e përshtypje provokative me jehona mediatike etj., gjë që nuk i bëhej fare letërsisë së mbetur të realizmit socialist.

Po rikujtoj:

1- Në fillim u tha se *nuk mund të kishte një letërsi e tillë*. Por ja që ajo erdhi. Është e dëshmuar.

2- *Që te ne s’mund të kishte letërsi disidente, sepse, siç dihet, diktatura në Shqipëri ishte më e egra në Europë, më mizorja, e çmendur dhe po të pranonim disidencën, për rrjedhojë do të dilte se diktatura te ne ka qenë e arsyeshme dhe e butë*. Vërejte e drejtë, por, që të mos zgjatem, e përsëris, disidenca letrare në Shqipëri nuk lejohej, ishte klandestine/ e fshehtë. Dhe metaforike e me gjuhë të Ezopit. As e rrymave letrare apo e bashkësive kulturore, por individuale. Shembujt tashmë janë, janë vepra me vlera të qëndrueshme në letrat shqipe.

3- Pastaj u dyshua edhe te sasia e tepërt e saj, u diskutuan deri edhe faqet dhe datat... *Letërsia shqipe është ngarkuar shumë me këtë lloj letërsie, duke çuar në kategorizimin e saj si letërsi burgu...* - më është thënë edhe mua së fundmi. I konsideroj provokime të duhura që të mund të thuash diçka.

Letërsia vetëngarkohet me realitetin dhe shqetësimet e tij, e di ajo (letërsia) se si, se ç’duhet të sjellë dhe ç’duhet të lërë, dhe kategoria “letërsi burgu” erdhi për ta dalluar, për të treguar temën dhe vendin zanafillor, siç vihet ndonjëherë vendi dhe data në fund të një romani. Jo vetëm kaq, është edhe përmbajtja që e dallon, qëndrimi gjithashtu.

Letërsia është një e tërë, një *Oneness*, pra është ose s’është si e tillë. Ligjësitë dhe kalendari i saj janë ndryshe dhe përcaktohen së brendshmi, nga vetvetja, përmbushjet dhe mangësitë, dhe nuk kanë të drejtë regjimet, institucionet e tyre, ideologët, shefat jo e jo, askush, që të matin nëse u shkrua mjaftueshëm ose jo për një kohë, epokë, luftë a paqe, për një vuajtje a dhembje të madhe të një populli a njeriu të vetëm, njëlloj është për letërsinë, por ne kemi të drejtë ta lexojmë, ta njohim, ta analizojmë, të kërkojmë, ta kritikojmë, ta ruajmë.

Harresa duhet të jetë vetëm letrare, si përforcim i kujtesës, ku duhet të mbeten vlerat që i përzgjedh e ardhmja dhe jo “harresat jashtëletrare”, të qëllimtat, politiket, përsundueset, të këqijat.

“Letërsia e burgjeve”, i detyruar ta përdor këtë term tashmë, nuk *erdhi të zëvendësojë letërsinë shqipe*, siç u trembën shkrimtarë të realizmit socialist, por për të sjellë vetveten, dhe kjo e drejtë s’mund t’i mohohet



gjithsesi. Kur edhe diktatura aq mizore e përndoqi, e mpaku, por nuk e zhduku dot, ajo s'mund të zhbëhet tani. Veçse rritet...

4- Dhe pastaj iu kthyen *cilësisë*, u godit *cilësia* e kësaj letërsie, më e rëndësishmja dhe kriteri më qenësor, *vlera letrare*. Prandaj dhe u tha se *na zhgënjeu letërsia e burgjeve*... Keqardhje? Cinizëm? Apo një krahëmarje kundër saj? Pse? Nuk durohej dot e vërteta dhe morali që solli? Vlerat? Në fakt, zhgënjyese mbetet letërsia e realizmit socialist.

“Letërsia e burgjeve” është një mrekulli ringjalljeje, do të thosha, se ajo u gatua në terret e vdekjes. Dhe në burgjet e diktaturës nuk është futur kurrkush për t'u bërë shkrimtar, përkundrazi, por për të mos shkruar dot, për t'i thyer “penën dhe kokën”.

Dhe është për t'u adhruar, së pari, akti i të shkruarit atje, ku ishte e ndaluar, shenjtëria e krijimit, e paguar edhe me çmimin e jetës. Dhe nëse doli nga burgjet dhe internimet qoftë edhe një poezi, një tregim, ca fletë ditari, një dëshmi letrare, është arritur misioni, jo më që kanë dalë qindra poezi, tregime të shumta e romane, ditarë e memuaristikë, sprova, drama e skenarë, një letërsi e tërë.

Horizonti i pritjes së letërsisë shqipe u zgjerua kështu, u pasurua me të vërteta, me metafora e metamorfoza etj., i treguam vetes dhe të tjerëve se qëndruam dhe dhamë vlera, edhe kur dukej e pamundur. Dhe bota e vlerëson këtë dhe tregon interes.

Pasi tronditën lexuesin shqiptar, kur është arritur të përkthehen, janë vlerësuar nga kritika jashtë si vepra me rëndësi përtej lokale, përtej kombëtares. Dhe qerthulli i kritikave të kësaj letërsie u bë më profesional dhe më domethënës.

KRYEVEPRA?

Po a është shkruar ‘kryevepra’ mbi vuajtjen e krimin në diktaturë? - jam ndeshur me këtë pyetje, ku fjala “kryevepër” ishte e futur në thonjëza.

Sipas meje, të gjitha “letërsitë” e të gjitha vendeve dhe kohëve tentojnë “kryeveprën” e tyre, prandaj vazhdojnë. Ky është një paradoks, “kryevepra” veç kërkohet pa pra dhe është duke mos ardhur që të mohojë të mëparshmet a të tjerat. Tragjedianët grekë nuk erdhën që të rrëzonin Homerin, përkundrazi. As Shekspiri të zëvendësonte Danten, as Servantesi Shekspirin, as Gëte, as Xhojsi, as Kafka etj.

Të zbresim te letërsia jonë. Fishta (i goditur nga diktatura sa edhe varrin ia shprishën) as nuk e zëvendëson dhe as nuk e rrëzon Naimin, as Kadareja De Radën (edhe ky i burgosur në Itali, por e liruan të ri, se ishte poet) apo Migjenin.

Poezia e Trifon Xhagjikës nuk zëvendëson atë të Vilson Blloshmit, as Jorgo Bllaci Frederik Rreshpen dhe asnjëri prej tyre, p.sh., Fatos Arapin.

Pra “kryevepra” është shkruar, besoj unë. Cila është? Të gjitha së bashku, e tërë ajo letërsi që e quajtmë “letërsi e dënuar” dhe shumë nga veprat e saj veç e veç. Varen nga leximet.

Letërsia shqipe, përgjithësisht, është letërsi martire. Ajo që në fillimet e saj nisi nën pushtim, me autorë të përndjekur, me poetë të vrarë e të syrgjynosur.

Po kaloj në kohën e romanit të parë shqiptar, te romancieri i parë, Dom Ndoc Nikaj, që u la të vdiste në burg, në diktaturë, plak 86-vjeçar. Romani i parë i letërsisë shqipe nuk është “Shkodra e rrethuese” e tij, botuar në 1913, por një tjetër, po e tij, “Marcia”, i 1889-ës, pra jo ajo e fillimit të shek. XX, por tjetra e fundit të shek. XIX. Na pëlqen kjo zhvendosje e së vërtetës. Por si të pranohej një subjekt biblik si fillim në kohën e socrealizmit?! I mbiquajtur “Balzaku shqiptar”, vepra e Dom Ndoc Nikajt ende nuk është botuar e gjitha dhe harrohet bashkë me të, duke u bërë pjesë dramatike e letërsisë së harruar.

Edhe tragjediani i parë dhe i vetëm shqiptar, klasik i Et’hem Haxhiademi, vdiq në burg, ashtu si dhe dramaturgu Kristo Floqi, pak ditë para lirimit. Mendohet se u helmuan. Dhe helmimi gjithsesi do të vazhdonte me forma të ndryshme në letrat shqipe.

Dhe vepra antropologjike, pararendëse, ajo e motrës së tyre të burgjeve, Musine Kokalari, shkrimtarja e parë

grua, disidentja e parë në perandorinë komuniste. Që mund të quhet edhe ajo “e pushkatuar”, iu vra shpirti, iu ndërpre krijimi, vetë jeta që iu shua para kohe në internim.

Shikoni sa poetë të pushkatuar ka poezia e re shqipe! Lemerit e vërtetë! Klasikët, si Dom Lazër Shantoja, Dom Ndre Zadeja, At Bernardin Palaj, Dom Aleksandër Sirdani, At Viçnes Prenushit, Baba Ali Tomori, Trifon Xhagjika – “Lorka shqiptar”, Vilson Blloshmi e Genc Leka – dy shokët baladianë, Havzi Nela, që futi i pari në poezinë tonë “Helsinki” e të drejtave të njeriut, i varuri i fundit në të gjithë perandorinë komuniste.

Natyrisht, ata nuk mund të kenë poezitë e pushkatimit të tyre apo të arrestit. Por ata dëshmojnë edhe ndërprerjen tragjike, e rëndë për kombin dhe e pazëvendësueshme ajo që ata do të mund të shkruanin. Dhe kështu ata së bashku bëjnë një antologji që trondit të gjitha letërsitë. Dhe e kam bërë. Ka fatin që është vetëm në shqip. Duan një përkthyes...

Po poezia në burg? Një tjetër antologji, një epos modern.

Të kujtojmë “Sonetet e Kanalit” të Arshi Pipës, “Ferri” i poezisë shqipe. Si i burgosur, i shkroi fshehurazi mbi letra të holla cigaresh, i gjithë libri ishte a s’ishte sa një kuti shkrepeje, me to u arratis dhe u botuan së pari në Romë, më 1959.

Në atë burg ishte edhe mjeshtri Mitrush Kuteli, ai që parapriu estetishtë në letrat shqipe, i përndjekur bashkë me veprën, me atë të rrëfyer shqipçe, gjithë zë dhe gërxhe, duke krijuar kështu një si shkollë, që harrohej.

Po kështu edhe Petro Marko, që e fusnin në burg në çdo kohë dhe s’mjaftonte një vend, me romanet e tij dhe memuaristikën, shkon te kryet dhe ky në letrat shqipe.


Shohim një kronologji romanesh të burgut të emrave: Astrit Delvina, Kasëm Trebeshina, Pjetër Arbnori, Mehmet Myftiu, Mustafa Grebllashi, Kin Dushi, Zyhd Morava, Halil Laze, Spartak Ngjela etj., që vazhdoi edhe pas burgut me autorë ish-të burgosur, si Agim Hamiti, Loni Mishtari etj., që e nderojnë letërsinë dhe mund të barabiten me botimet kudo.

Romanet e Bashkim Shehut dhe të Fatos Lubonjës kanë njohur përkthimin dhe kanë marrë vlerësime të denja si për çdo kryepunë. Po kështu edhe romanet e Henrik Gjokës janë vlerësuar me çmime.

Makesen Bungo, i burgosuri i kënetës së Maliqit, ka botuar dy herë romanin tronditës “Kënetat e vdekjes”, sfidues dhe shkatërrues i një romani tjetër paralel të socrealizmit, “Kënetat”. (Më gjerë si dukuri e kam trajtuar në sprovën “Panteoni i nëndheshëm ose Letërsia e dënuar”).

Kam bindjen se letërsia e dalë nga burgjet e rrënon moralisht e jo vetëm, së bashku me kohën, letërsinë e mbetur të realizmit socialist.

Monumentale, e vlerësuar edhe jashtë, është



memuaristika romanore e At Zef Plumit, “Rrno për me tregue”. Maja janë edhe veprat e korpusit të shkrimtarit, studiuesit, poetit dhe përkthyesit Lazër Radi.

Vazhdojmë me emra të tjerë të dënuarish, ku përzihen studimi, dokumenti dhe një lëndë e begatë letrare: Sami Repishti, Ejëll Çoba, Gjergj Bubani, Amik Kasoruh, Petrit Velaj, Gjergj Titani, Bedri Blloshmi, Reshat Kripa, Tanush Kaso, Gëzim Peshkëpia, Petrit Kalakulla, Agim Musta, Leka Tase, Beqir Ajazi, Eugjen Merlika, Maks Rakipaj, Gëzim Çela, Skënder Tufa, bashkëshortët Liri dhe Todi Lubonja, Fatbardha Saraçi Mulleti, Miho Gjini... kujtoj tregimtarët e së ashpër dhe të së brishtës, Bedri Çoku e Astrit Xhaferri, e deri te botimet më të vonshme, te prozatorët Hasan Bajo, Dine Dine etj.

Veçoj artistin Maks Velo se, krahas veprës letrare, poezi e prozë, ai ka edhe një vepër të suksesshme në pikurë, skulpturë e arkitekturë, që është profesioni i tij. Po kështu edhe Lekë Pervizi, shkrimtar dhe piktor.

I rikthehem yllësisë së natës dimërore në diktaturë, të poetëve të burgjeve dhe të internimeve: Kudret Kokoshi, Pano Taçi, Zef Zorba, Jorgo Bllaci, Frederik Rreshpja, Uran Kostreci, Pirro Kuqi, Jamarbër Marko, Daut Gumeni, Gëzim Metolli, Ylber Merdani, Zeus Çoku, Luan Burimi, Pëllumb Lamaj, Ahmet Kolgjini, Gjergj Peçi, Bajram Hyseni, Jusuf Alibali, nga internimet: Vehbi Skënderi, Jozef Radi, Ferdinand Laholli, Drita Çomo, Vitore Stefa etj.

Dukuri me rëndësi është edhe dramaturgjia e të persekutuarve, veprat e Leka Totos, Hekuran Zhitit, Minush Jeros etj.

Po drama e habitshme “Rrajët lëvizin” e emigrantit politik, i dënuar me vdekje në mungesë, themeltar në tregimin modern shqiptar, Ernest Koliqi? Moshatar me George Orwell-in ai shkroi, si të thuash, veprën “antioruelliane”, “anti 84”, që parashikonte rënien e komunizmit, aty nga vitet ’70 të shekullit të kaluar, “gabo një ose dy dekada, por një libër të tillë nuk e ka e gjithë letërsia e Lindjes.

Edhe unë jam në këtë aradhe autorësh të ferrit dhe pata fatin, ndër të paktit, të nxjerr gjallë nga burgu rreth 300 poezi, të shkruara fshehurazi. Dhe i dënuar isha për poezinë, nuk duhej të shkruaja më, me gjyq. Shumicën e tyre e kam botuar tani. Janë përkthyer edhe



në gjuhë të tjera, madje edhe janë kompozuar. Po kështu krijova burgologjinë time për Spaçin, “Rrugët e Ferrit”, dhe Qafë-Barin, “Ferri i çarë”. Vazhdova me romanet “Perëndia mbrapsht dhe e dashura” dhe “Në kohën e britmës” etj., të pritura mirë nga lexuesi ynë dhe i huaj.

Talenti i përbashkët, mundimi golgotian në burgje e internime arritën të jepnin një afresk madhor, tragjik, të ferrit shqiptar, e gjitha një kryevepër, formësuar prej të tillash.

UNIVERSALJA APO UNIVERSALIZIMI?

Dalim atje ku e nisëm, tek *universalja* e letërsisë sonë të dënuar “të kujtesës”. Ia ka dalë të jetë e tillë apo ka mbetur te *personalja*? Natyrisht, në mendimin kritik, që më shumë duket se mungon, si të thuash, s’është si institucion, boshësia e tij është mbushur me mosbesim, me njohje të mangët, mënjanësi ku edhe ngrehina e Kujtesës Kombëtare ka pjesë të rrënuara, teksa shfryn vazhdimisht mendësia e së shkuarës, që e çorodit dhe moleps kujtesën kolektive.

Përvojat dhe arritjet në letërsi s’kanë si të mos jenë personale, ndërkaq universalja është lokalja pa mure, thoshte poeti Fernando Pessoa, dhe ashtu është.

Lokalja/ përvoja personale në prurjet e “letërsisë së kujtesës”/ të burgjeve dhe internimet, pra janë, madje të begata në rrëfime e kumte, për vete e të tjerët, të huajt, në ndjesi e ide, në dëshmi dhe art... që aq sa origjinale është, po aq dhe barabitëse me çdo “letërsi kujtese” tjetër, madje dhe habitshme – e prodhuar nga një popull i paktë dhe në majat e saj kjo letërsi gjithsesi ka *qasjen universale*. Vuajtja dhe njeriu i saj, shpresa dhe njeriu i saj, ëndrra për liri, përvoja vetanake janë të universalta te kjo letërsi, edhe realizimi, sa klasik, po aq dhe modern, ku ka ngjizme të traditës me risinë, por e pauniversalizuar aq sa meriton e do të duhej, pra “muret” përreth kësaj letërsie janë, normale që do të ishin, pra i gjeti, jo se i vetëngriti.

Qëllim do të ishte shembja e këtyre mureve. Kjo letërsi duhet “të dalë edhe nga burgu” i saj, – po përdor titullin e një shkrimi të studiuesit Ndriçim Kulla për shkrimtarin Astrit Delvina – dhe ky “burg” s’është vetëm mosbesimi i vetes, pozitive më shumë kjo, dhe i të tjerëve, negative më shumë kjo, por mënjanimi dhe harresa, të qëllimta ose jo, nëvleftësimi, i qëllimtë ose jo, mospërkushtimi ndaj saj, mosmbështetja ndaj saj, të qëllimta ose jo. Të qëllimta më shumë, besoj.

Letërsia jonë e kujtesës e ka bërë detyrën. Meriton *mirënjohjen*, pra njohjen e mirë. Nga universalja e saj origjinale duhet kaluar në universalizimin e saj. Së pari, duhet të nisë nga brenda.

PUNA ME PËRKTHIMIN

Ndërkaq, në njohjen e saj nëpër botë, në bërjen e saj universale dhe “gjeografikisht” e pengon edhe fati i gjuhës amë, e cila i përket një populli të vogël në numër. Absolutisht që është gjuhë e bukur dhe e lashtë, me vlera, që mbart çdo kryevepër, botërore dhe tonat.

Për paradoks, unë do të doja vërtet edhe ca “përkthyes të veçantë” që letërsinë tonë të kujtesës “ta përkthenin” nga shqipja në shqip për shqiptarët që ta njihnin më shumë e ta donin dhe pastaj të punohet për më tej. Se përpjekjet janë vetanake më shumë, me mundësi të pakta deri më tani.

Vitet e fundit u ishte dhënë një rëndësi institucionale për kthyesve më shumë se autorëve, atyre nga gjuha e huaj në shqip, ndërkohë është shuar shkolla e madhërishtme e shqipëruarve të burgjeve dhe internimeve, heronjve të fjalës, si Gjon Shllaku i “Iliadës”, Pashko Gjeçi i Dantes, Guljelm Deda i Ariostos, Vexhi Buharaja i Saadiut etj., të cilët aty derdhnin talentin e madh e të ndaluar si poetë... Pra, kur do të duhej, në mos më shumë për çështjen që po trajtojmë, e ndërsjellta, të mbështeteshin përkthyes nga shqipja në gjuhë të tjera, si Jusuf Vrioni, edhe ky i burgosur, që dha në frëngjisht veprën e përbotshme të Kadaresë, apo të huajt, si Robert Elsie, apo, në nderim të tyre po përmend nga ata që njoh, si Joachim Hans Lancsh, Aleksandër Zotos, janë arbëreshët, si Elio Miracco, Kate Zuccaro, Eugenio Scalabrino etj., por ka edhe shqiptarë të tjerë të talentuar, si Luan Topçiu, Smajl Smaka etj., e kam fjalën veç për kalimin e veprave të letërsisë sonë të dënuar në gjuhët e tjera të mëdha, si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, greqisht, polonisht e në gjuhët sllave të Ballkanit.

Që të çmohet “Letërsia e dënuar e kujtesës”, si jashtë dhe brenda vendit, nuk është më edhe aq punë e vetë shkrimtarëve, por e shoqërisë, e institucionit të kritikës dhe institucioneve gjegjëse, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit, akademive dhe universiteteve, të shoqatave, jo vetëm të të persekutuarve, mecenatëve të kulturës etj., patjetër edhe e Shtetit. T’i jepet vendi i duhur në studime, të jetë e qëndrueshme në Kulturën Kombëtare, të zërë vendin e merituar në tekstet shkollore, deri dhe universitare. Si të thuash, duhet zyrtarizuar si e tillë dhe pastaj është detyrë e shoqërisë përsëri, për t’ua bërë të njohur të tjerëve. Botës. E meriton.

Duke parë përvojat e vendeve të tjera, që janë dhe sa ne, Izraeli, p.sh., një kulm botëror, por edhe e më të vegjëlvë se ne dhe ngjitur, Maqedonia e Veriut, p.sh., dhe nga e kaluara, nga diktatura që punonte për përhapjen e veprave që i duheshin, edhe mbretëria, që, p.sh., paguante florinj për përkthimin e “Lahutës së Malcis”.

Malet e Shqipërisë kanë dhe veprat e shkrimtarëve, një tjetër vargmal ky, i shpirtit dhe i identitetit.



BLOCKNOTE

STEVENSON: NGA IDETË E FUNDIT

nga Aurel Plasari



Emri Robert Louis Stevenson (1850-1894) është tanimë ai i një shkrimtari botëror. Më së shumti i lexuar si shkrimtar aventurash ose ndryshe peripecish, – “Ishulli i thesarit”, “Shigjeta e zezë”, “Rasti i çuditshëm i doktor Xhekillit dhe zotit Haid” etj. – më pak është njohur si autor shënimesh udhëtimi, si eseist, si kritik letrar etj.

Edhe për vete prej romaneve të aventurave kam pas bërë të njohur me të qysh prej magjepsjes në fëmijëri nga “Ishulla e thesarit”, që në ato kohë nuk duhej qarkulluar: “Ishulla” ishte e ndaluar për shkak të përkthyesit të saj të përsyshur, Tajar Zavalanit. Po njësoj qenë të ndaluara, prej Zavalanit themelues të përkthimit modern shqiptar në vitet ’30 të shekullit të kaluar, edhe “Zonja me kameliot”, edhe “Tartarini i Taraskonit”, edhe “Gobseku”, edhe “Sonata e Krojcerit”, madje edhe “Anna Karenina” e tij etj.

I pasionuar i udhëtimeve, i përfytyruar gati-gati si vagabond, vitet e fundit të jetës Stevenson i përfundoi duke u endur ndër ishujt e Paqësorit Jugor. Aty në ishujt Samoa edhe u vendos, më së fundi, tok me familjen e përbërë nga e bija dhe i biri të gruas së tij prej martesës së saj të parë, tanimë e vdekur, Bella dhe Lloyd Osbourne. Këta e respektuan dhe e deshën “njerkun” si atin e tyre. Për këtë bir të sjellë nga gruaja, Lloydin dikur 15-vjeçar, Stevenson kishte pas shkruar të parën vepër të vet famëmadhe, “Ishulli i thesarit”, atë roman të cilin edhe Borgesit e paska përjetuar – para

nesh – si një nga format e lumturisë në fëmijëri.

Thjeshtri i tij Lloyd Osbourne tanimë i rritur, që më mbas do të bëhej edhe vetë shkrimtar, i qëndroi pranë Stevensonit deri në fund duke e përkujdesur dhe duke ia plotësuar deri edhe amanetin ekscentrik për banesën pasvdekësore. Ai ka shënuar e treguar edhe bisedat më të fundit me shkrimtarin në ndërkohët e lira ndërsa ky shkruante të pambaruarin “Weir of Hermiston”, ndoshta kryeveprën e vet. Kuptohet, prej bisedash të tilla, që Robert Louis Stevenson nuk paskësh qenë thjesht ndonjë “aventurier” bredharak i dhënë mbas jetës nomade, por njeri mendimi të thellë. Dhe jo më kot me veprat e veta paskësh parapëlqyer t’i ikte “realitetit borgjez” duke thurur ëndërrime me vise vetmitare gjithë magji.

Një mbrëmjeje, ndërsa shëtisin para lëndinës së shtëpisë, shkrimtari i mirëbesohet Lloydit: “Nuk jam njeri me ndonjë talent të jashtëzakonshëm, Llojd. Kam filluar me mundësi shumë të pakta. Suksesi im i detyrohet zellit tim të jashtëzakonshëm për punë, falë të cilit zhvillova deri në skaj gjithë sa pata në vete. Kur një njeri fillon t’i përkryejë aftësitë e veta dhe vijon t’i përkryejë ato me ngulm të pareshtur, mund të bëjë mrekulli. Të gjithë e dinë, të gjithë e kuptojnë, e megjithëkëtë sa e vështirë është të gjesht dikë që ta bëjë! E kam fjalën që ta bëjë deri në fund, siç e bëra unë. Në pati tek unë ndonjë gjë gjeniale ishte gjenia e punës.”

Një ditë tjetër, i ulur në verandë në karrigen e tij të



xunkthit, i bën këtë pohim kërsheor: “Çdo shkrimtar që vlen diçka, vdes dhe rilind papushim. Dje po lexoja “Virginibus Puerisque” dhe m’u duk mjaft i mirë, por i lindur nga një dell që tanimë do ta kisha të pamundur ta ngjallja sërishti aq sa do ta kisha të pamundur të fluturoja. Tani puna ime është më e thellë nga ajo e dikurshmja, mund të mbërrij emocione të cilat asohere mezi i dija që ekzistonin. Kjo do të thotë se Stevensoni që shkroi “Virginibus” ka vdekur dhe është varrosur, madje prej shumë motesh.”

Atje, në ishujt gjysmë të egër të Paqësorit Jugor, shkrimtari shfryn para mikut Lloyd: “Sa keq që e përdorin francezët lirinë e tyre! Nuk shohin tjetër gjë që t’ia vlejë përpos trekëndëshit të përjetshëm; ndërsa ne, që kemi mëgojëzën në gojë si qentë, dhe një kënd vështrimi pafundësisht më të gjerë, jemi të dënuar ta injorojmë gjysmën e jetës që na kalon përbi. Ç’libra do të kishte mundur të shkruante Dickens po t’ia kishin lejuar! Përfytyro një Thackeray pa zinxhirë, të lirë si një Flaubert a një Balzac! Ç’libra do të kisha mundur të shkruaja unë vetë! Mirëpo neve na japin një kutizë me lodra e na thonë: ‘Nuk duhet të luani veçse me këto.’”

Një ditë tjetër: “Arma e borgjezisë është uria. Nëse ti si shkrimtar ose si artist shkon kundër opinionëve të tyre të ngushta, ata në heshtje e thjesht fare të heqin mjetet e jetesës. Nganjëherë pyes veten se sa persona gjeniale dënohen në këtë mënyrë çdo vit.”

Kurse një mbasdite, ndërsa miqtë atypari luajnë tenis: “Ne nuk jetojmë për nevojat e jetës, për to në fakt askush nuk çan kokë; ne jetojmë thjesht për gjërat e tepërta, të kota [superfluities].”

Madje në një moment: “Spektakli më i trishtë i qytetërimit dhe për mendimin tim dëshmia më e madhe e dështimit të qytetërimit, është njeriu që mund të punojë, që do që të punojë dhe të cilit nuk i lejohet të punojë.” Shkrimtari vdiq më 3 dhjetor 1894 po në Samoa. Me ndihmën e vendasve që e adhuronin njeriun Stevenson, Lloyd Osbourne-i e varrosi aty, simbas amanetit, në një majë mali: së andejmi vështrohej deti përpara, mbas shpine një pyll zanafillor, humnera, ujëvara të largëta dhe një visore që, me gjasë, këmba e njeriut nuk e kishte shkelur ndonjëherë. Po asaj mbrëmjeje u ul e filloi të hidhte në një blocknote kujtimet me titull *Vdekja e Stevensonit*. Janë nga ato kujtime falë të cilave lexuesit mund t’i njohin shkrimtarët edhe prej jetës së tyre, sidomos mendimeve të tyre, jo vetëm prej teksteve “fiksionale”.



SHUMËLLOJSHMËRIA KRIJUESE E MID'HAT FRASHËRIT

Vepra të zgjedhura 3, Instituti i Studimeve Historike Lumo Skëndo, Tiranë, 2018

nga Bashkim Kuçuku



Vepra e shumanshme e Lumo Skëndos/ Mid'hat Frashërit ka qenë përherë e domosdoshme dhe e dëshiruar për shqiptarët, kudo që kanë qenë, me përjashtim të të padritëve të ideologjizuar, se, me sistemin e vet filozofik, politik, shoqëror e kulturor që ofronte, ishte në kundërshtim me utopitë e tyre negative. E mbyllur në shtatë çelësa për të mos e gjetur, e keqparaqitur dhe e përbaltur gjatë gjysmë shekulli për ta zhvlerësuar, më në fund, lexuesi për herë të parë po e merr në dorë kaq të gjerë, në një sistem të vijueshëm, në 12 vëllime, dhe të organizuar sipas llojit të dijeve, të fushave studimore e letrare. Me idealizmin sakrifikes, përkushtimin atdhetar dhe palodhshmërinë, me llojshmërinë e pabesueshme të fushave të lëvruara prej tij, me ndikim formues tej kohës që jetoi dhe tej atdheut të vet, Shqipërisë së njëmendtë, në një shqipe të kulluar e të formësuar si rrallëkund në atë periudhë, ajo është në themelet e patundshme të kulturës, dijeve, lirisë e të qytetërimit të shqiptarëve.

Puna akademike e historianit dhe e shkrimtarit Uran Butka

Për ta nxjerrë prej errësirës së ndalimit në dritën e së vërtetës së vet, faktit, kanë punuar historianë, shkrimtarë e publicistë të ndryshëm. Megjithatë, botimet e saj dhe studimet për të kanë qenë të pjesshme, të pamjaftueshme dhe të paorganizuara në një korpus të madh. Historiani dhe shkrimtari Uran Butka i është përkushtuar figurës dhe veprës së tij. Ka shkruar e përgatitur disa libra: *Kthimi i Mid'hat Frashërit* (1997), *Dritë mbi veprën e Mid'hat Frashërit* (1997), *Gjeniu i kombit* (2001), *Elita shqiptare* (2008), të cilat parathoshin përmasat madhore, të njohura dhe të panjohura deri sot.

Duke qenë mjaft e pasur, e shtrirë në shumë fusha dhe në disa gjuhë, e botuar dhe në dorëshkrim, e shpërndarë në organe të shtypit shqiptar dhe europian, botimi tërësor i saj kërkonte projekte publike afatgjata të institucioneve shkencore, të Akademisë së Shkencave, të cilat, në dhjetëvjeçarët e pluralizmit, do të ishin kryer. Në mungesë të projekteve të tilla, Uran Butka e mori vetë përsipër. Me

një grup kolegësh krijoi Institutin e Studimeve Historike *Lumo Skëndo* (2016) për të hedhur dritë mbi ngjarje dhe figura të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, kryesisht, të anatemuara ose të braktisura për arsye politike. Në katër vjetët e veprimtarisë, instituti ka nxjerrë rreth 20 libra studimorë, ritmikë kjo konkurrese me institucione publike, ku punojnë grupe specialistësh të përhershëm. Pësja e rëndë e tij janë: *Mid'hat Frashëri Vepra të Zgjedhura* 1 (2017), 2 (2018), 3 (2018) dhe 4 (2019), e sapodalë, dhe në vijim, falë punës akademike, hulumtuese, studimore, organizuese të Uran Butkës në të cilat do të përfshihet edhe bibliografia, e përgatitur nga Maksim Gjinaj. Botimi me cilësi të lartë teknike, paraqitje estetike, deri në zgjedhjen e ngjyrave emocionuese të mbulesës, është nën kujdesin e z. Bujar Hudhri, president i Onufrit. Projekt tjetër i rëndësishëm do të jetë *Vepra e plotë* e filozofit dhe e shkrimtarit Isuf Luzaj. Përvoja e këtij institucioni jopublik që kryen detyra të pakryera të institucioneve publike, është një gjedhe se si aftësitë shkencore, idealizmi atdhetar e kulturor, edhe me organizim modest, japin ndihmesa të mëdha. Për arsyet tona profesionale do të përqendrohemi në *Vepra të zgjedhura* 3, veçanërisht në krijimtarinë letrare të Lumo Skëndos/ Mid'hat Frashërit.

Letërsi, historiografi, antropologji, albanologji

Vëllimi 3 përmban: proza, të botuara dhe të pabotuara, kujtime, fjalë të urta, paraqitje librash, analiza dhe kritika, bibliografi albanologjike, çdonjëra ndihmesë më vete në letërsinë, studimet letrare dhe historike, antropologjinë, kulturën shqiptare. Prozat e Lumo Skëndos prej një shekulli kanë qenë në leximin dhe në historinë e zhvillimit të tregimtarisë shqipe.

Kujtimet, një lloj shkrimtarie midis letërsisë dhe historiografisë, për shkallaren kulturore të lexuesit, në atë periudhë, ishin të pëlqyera, sepse plotësonin anasjellat kërkesat dhe mangësitë e njëra-tjetrës. Kujtimet e Mid'hat Frashërit, origjinale në këndvështrimin e atdhetarizmit/ shqiptarizmit idealiste, të pasura në të dhëna mjedisore e historike, janë origjinale edhe në letrarësi. Të përfutur nga ngjarje dhe bëma të figurave historike, për të qenë sa më afër njëmendësisë së tyre, janë shndërruar në rrëfime të kompozura, kryesisht, realiste me doza romantike e patetike, herë-herë me dramatizëm.

Rrëfimet për ngjarjet zhvillohen, duke u këmbyer me portretizimin e pjesëmarrësve në to nëpërmjet ligjëratës së rrëfimit autor dhe dialogëve të tyre karakterizues, që zbulojnë me përparësi tiparet psiko-morale atdhetare dhe cilësitë vetjake. Portretizimi i figurave historike nuk është nisur nga njohja e rastit, as nga dëshira për të kënaqur thjesht kërshërinë e lexuesit, por nga qëllimi i dokumentimit të cilësive dhe bëmave të njëmendta të tyre. Dhe, meqë ky është qëllim shoqëror, pastaj letrar, edhe kriteret e portretizimit janë shoqërore, pastaj letrare. Qëndrimi i shkrimtarit është i përcaktuar, nga njëra anë, nga idealizmi i pastër atdhetar/ shqiptarizma, lartësia kulturore dhe morale, që ka zgjedhur për gjedhe dhe, nga ana tjetër, nga funksioni shtetëror apo misioni shoqëror i figurave historike. Konkretisht, sa dhe si i përgjigjet kultura, inteligjenca, morali qytetar atij funksioni. Portreti më i arrirë letrarisht është i Naim Frashërit, me përshkrimin psikologjik, ndjeshmërinë poetike dhe njerëzore, pastërtinë morale, dhembshurinë, ëmbëlsinë e këshillës dhe ndihmën ndaj kujtdo. Tek ai, autori njëmendësisht ka gjetur harmoninë mes njeriut, poetit dhe misionit shoqëror atdhetar, të cilën e ka pikturuar me ngjyresat e fjalës së hollë shqipe. Arritja letrare është përfutur edhe nga një harmoni e brendshme e subjektit krijues. Në

filozofinë dhe veprimtarinë e Mid'hatit, vëllezërit Frashëri, i ati, Abdyli, dhe ungjërit, Naimi dhe Samiu, ishin gjedhja e misionarit, shëmbëlltyrën e të cilëve ia jepte vetes, dëshironte e punonte ta kishte çdo shqiptar.

Spikasin me rëndësinë shoqërore dhe letrarësinë: *Kujtime, 1912* për qeverinë shqiptare, në Vlorë, të vitit të parë të pavarësisë, funksionimin e brendshëm të saj, mbledhjet, ministrat, virtytet dhe dobësitë, dhe *Tiranë, 5 nëntor 1922*, për organizmin dhe funksionimin e qeverisë, të administratës, mungesën e kulturës së përshtatshme, të mospunuarit, dhënien pas fjalëve dhe bixhozit. Te *Kujtime, 1912*, si rrallë në këtë lloj të shkrimtarisë shqipe, ministrat e qeverisë së parë të Shqipërisë, ndonëse me intimitet dashamirës, vizatohen me ngjyra humoristike e groteske. Burimi i humorit dhe i groteskut është mospërputhja e formimit kulturor, e aftësive të tyre me rëndësinë e detyrës, e përgjegjësisë së madhe me ngadalësinë dhe amatorizmin e punës, pasojë e mungesës së kushteve dhe të përvojës. Portretet-sharzh (komike) të nëntë ministrave dhe të kryetarit, më tepër se aftësitë e virtytet, kanë të trashuara mangësitë, dobësitë e veset, herë-herë, paraqitjen fizike të shëmtuar, gjestet vulgare. Ministrat janë nëntë, por në mbledhje shumë herë hyjnë edhe të tjerë dhe bëhen nëntëmbëdhjetë. Pesë janë *pepe*, dy nuk dëgjojnë mirë dhe tre janë të belbër, flasin me pengime, duke përfshirë dhe vetë Mid'hatin. E dhëna fizike e njëmendtë është parashenja komike për të tërhequr vëmendjen te moskuptimet dhe mospajtimet, pavarësisht se, për hir të njësisë, merren vesh në vendime. Kryetari i qeverisë, Ismail Qemali, shëmbëllet me tre epitete: "*maçoku*", *beu*, *Plaku*. "*Maçoku*", se rri në krye të kuvendit/ vatrës, ku rri maçoku, dhe në punë nuk u lë pjesë të tjerëve. *Plaku* se është më i moshuari, i urtë, e dëgjojnë dhe duhet ta respektojnë. *Bej*, është përmbi ta, bën sikur i dëgjon e do mendimin e të gjithëve, por, kur vendos, nuk i pyet. Qëndrimi dhe karakteri i dy ministrave përballë detyrës është paradoksal. Ai i Luftës nuk do oficerët e rinj, as projektet e tyre për milici dhe xhandarmëri. I Punëve të Brendshme rri me frikë dhe përhap frikë, se mos vjen komandanti i forcave turke për t'i ndëshkuar. Edhe autoportreti humoresk i autorit rrëfimtari përftohet nga kundërtënia e vlerësimeve të të tjerëve me mendimin e vet.

Kultura - lidhje letrare e ndërletrare

Mid'hat Frashëri, me dije enciklopedike, politike, albanologjike, antropologjike, historiografike, sociologjike, dallohej edhe për kulturë psikologjike e letrare. Me kulturën prej së cilës është përfutur, qoftë edhe me atë letrare, disa proza të tij risore, në trajta bërthamash, kanë prirë proza të caktuara të shkrimtarëve shqiptarë pasardhës. Kështu, ato dalin nyje të ngjizjes së atij homogjenizmi kulturor, tematik dhe llojor të prozës shqipe me përbërës të njëjtë a të afërt, që u formësua në dhjetëvjeçarët të mëvonshëm. Për ta argumentuar, do të veçohen tregimet *Or' e fundit*, *Plaku i Ylynecit* dhe përsëri proza poetike *Përpara shëgës me lule*.

Cilësi risore të tilla, jo të kontekstit të prozës së atëhershme, vënë në diskutim mendimin se është realiteti shoqëror që detyron tematikat e qëndrimit. Ndoshta, më tepër apo më parë se realiteti shoqëror, është kultura që e nxit dhe e detyron ndjeshmërinë ndaj realitetit, perceptimin, trajtimin e tematikës dhe qëndrimin. Tregimi *Or' e fundit*, Shkodër, 25 maj 1913 (vëllimi *Hi dhe shpuzë*, 1915), është me tematikën e gjakmarrjes, një dukuri shumëshkulllore në botën shqiptare, që, në trajta të degjeneruara, vepron edhe sot. Të përcaktohej letërsia vetëm nga forca e realitetit, do të duhej të ishte trajtuar edhe nga shkrimtarë të tjerë



bashkëkohës të Mid'hat Frashërit, pse jo edhe paraardhës. Në një rrafsh më të epërm dhe më të ndërlikuar është trajtuar nga Ernest Koliqi (*Gjaku*, 1929), Ismail Kadareja (*Prilli i thyer*, 1980; *Lulet e ftohta të marsit*, 2000).

Mid'hat Frashëri, në mjegullat e mendësive arkaike të kohës, gjen zgjidhje shpirtërore, te falja e krishterë në emër të sakrificës së Jezusit dhe të një fladi të lehtë tolerance, që kishte nisur të vinte prej shkollimit perëndimor. Mirëpo, në botën shqiptare ende ishin të pafuqishme përballë egoizmit të verbër të gjakmarrjes së ngulitur në shekuj. *Or' e fundit*, me konflikt të fortë psikologjik, është ndërtuar në mënyrë dramaturgjike. Pak përshkrim i brendësisë së shtëpisë së varfër malësore me disa hollësi e orendi dalluese, dialogë të karakterizimit psikologjik, të shkurtër e të prerë, me gjendje dhe veprime të personazheve si në dramë. Me receptim më se njëqindvjeçar është ndër tregimet përrues me mjeshtëri arti të mirëfilltë.

Ernest Koliqi, në atmosferën e shkollimit perëndimor, që po niste në Shqipëri, e sheh kapërcimin e gjakmarrjes të zgjidhja shoqërore, në ndryshimin e mendësive tradicionale të vjetruara nëpërmjet shkollimit dhe vetëdijes racionale të tolerancës. Heroi i prozës së tij psikologjike *Gjaku*, mësues, që përcjell te nxënësit mendësi të qytetërimit europian bashkëkohor, ndonëse kundërshtar i flaktë i zakoneve prapanike, nën tryshinë e mjedisit, bie viktimë e tij. Nuk mjafton individi që bie theror, as propaganda vetjake. Shpëtimi prej moçalit të gjakmarrjes është shkollimi e qytetërimi, ndryshimi rrënjësor i shoqërisë, i mendësive, moralit, ligjeve të saj.

Ismail Kadareja te *Prilli i thyer* jep një zgjidhje universale, filozofike dhe emocionale. Në ndeshjen fatale mes jetës dhe vdekjes së pashmangshme ngrihet në shkallaren e epërme të madhësisë dashuria për jetën, fuqia morale e njeriut për t'i dalë më të keqes ballas.

Me *Plaku i Ylyncit*, shkruar në Vlorë, 11 mars 1913 (vëllimi *Hi dhe shpuzë*, 1915), mund të thuhet se fillon tregimi fantastik shqiptar. Zanafilla krijuese ka përbërës biografikë të familjes Frashëri. Hapësira gjeografike e lëvizjes është një udhëtim i heroit rrëfimtari përgjatë lumit të Vjosës që kalon në Përmet. Në malësi të tij është Frashëri, vendlindja e të parëve dhe të të atit të Mid'hat Frashërit. Ngasja prej vendlindjes së tyre, ndoshta, e pangjitur në vetëdijen krijuese të autorit, prandaj dhe e paqëllimshme, është shndërruar në art letrar, në histori, legjendarizim dhe mitizim. I atit i tij, Abdyl Frashëri, dhe ungjërri, Naimi dhe Samiu, qenë ndër më të rëndësishmit, që u mësuan shqiptarëve histori, letërsi dhe shkencë, dhe po ashtu, bënë histori, letërsi e shkencë.

Ecuria e tregimit është figuruar filozofikisht e letrarisht mbi përngjasimin e kohës me rrjedhën e lumit, përngjasim i filozofisë së lashtë greke (Herakliti), i cili haset edhe në filozofinë popullore shqiptare. Qenësia dhe lashtësia shqiptare tërthorazi janë njësuar me qenësinë dhe lashtësinë greke. Shkëmbi, shpella ku shfaqet Plaku dhe bota fantastike janë simbole të lashtësisë, por vetëdija e tij është edhe bashkëkohore. Lumi që rrjedh, Vjosa, është koha e shqiptarëve, me shtresëzimet historike më të rëndësishme. Ajo ka parë *grigjet e Pellazgëve, ushtërit' e Piros, legjionet e romanëve, ushtarët e Skënderbeut, Allajet e Turqve, njerëzit e Ali Tepelenës, shokët e Tafil Buzit*. Bashkë me kohën, nëpërmjet lidhjes me vendburimin e lumit, njësohet edhe hapësira shqiptare me hapësirën e Greqisë së lashtë. Vjosa buron nga malet e Pindit në Greqi. Ecja në të kundërt të rrjedhjes së lumit dhe të kohës, për mbërritur te burimi, në Greqi, shpie te lashtësia historike dhe mitike e saj. Tregimi mitizon historinë pellazgo-shqiptare, Vjosën dhe Përmetin/ Frashërin, që ishte "burimi" kryesor prej nga dolën rilindasit e mëdhenj dhe nëpërmjet tyre mitizon Shqipërinë, një mënyrë autosugjестive dhe sugjестive, për të bindur autori veten dhe lexuesit në një të nesërme të sigurt të saj.


Në një rrafsh të dytë, më konkret, koha personifikohet me Plakun e Ylyncit. "Jam koha, - thotë Plaku. - Jam i keq dhe i mirë. Kam nomët e mi. Kam vdekjen dhe gjallërinë. Brenda në këtë shkëmb po ruaj botën."

Shëmbëlltyra e tij ka tipare e bëma fantastike dhe legjendare. Mosha e papërcaktueshme: *gjashtëdhjetë, nëntëdhjetë, njëqind apo dyzet vjeç? Flokët e bardhë, si dëborë malë, përvoja, urtësia, pastërtia, vërtetësia e të thënave janë bashkëngjitur me një fytyrë djaloshi plot shpirt e shëndet, me sy të kaltër si ujë e Vjosës*, simbol i rinisë së përjetshme dhe i pavdekësisë. *Këmbët e çeliktë janë të vogla dhe të bukura. Veshja - një napë e gjatë e hollë, me fije të hekurta...* Ai është i njohur për rrëfimtarin. E njohura është e tanishmja. Por nuk e di cili është. E panjohura është e ardhmja. Heroi rrëfimtari përjeton në njëmendësi/ realitet. Ka udhëtuar përgjatë

Vjosës dhe ndodhet përballë një shkëmbi madhështor. Me shpellën që hapet, prej nga del Plaku, përjeton si në ëndërr, sheh një botë fantastike.

Mendimi kalon nga bota shqiptare në mbarë planetin, të ndarë në dy pjesë. Mënjatë është *skëterra, me ata që kanë jetuar e kanë vdekur, me gërmadha, anije të copëtuara, kufoma, eshtra e skelete njerëzish, me moçale e gjarpërinj, bota e vdekjes* à la Dante dhe à la Kuran. Më anën tjetër, *lëndina e jetës, me luadhe, brigje, kopshte, me qytete të zbuluar, njerëz të gjithë tok me punëtorësi të palodhur, plot bekim, idealizmi, utopia* à la Mid'hat Frashëri dhe e utopistëve të mëdhenj botërorë.

Koha e lashtë, mitike dhe historike e pellazgëve, dhe periudhat e mëvonshme priten nga bashkëkohësia, viti 1913, kur është shkruar tregimi në Vlorë, disa muaj pas pavarësisë dhe në vigjilje të Luftës Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, të cilat do ta rezikonin Shqipërinë me fshirje nga harta ose me copëtim. Tregimi fantastik për të kaluarën, në pikëprerjen e bashkëkohësisë, që njësion kohën e rrëfyer dhe kohën e rrëfimit, shndërrohet në simbolikë të fatit të saj ende në pikëpyetje qenësore/ ekzistenciale. Ky është thelbi i tij, filozofik dhe historik. Djepi me foshnjën e bukur, në të cilin është shkruar SH.Q.I.P.Ë.R.I.A., luhetat në tehun e humnerës, në do të bjerë në skëterrë apo në hapësirën e jetës dhe të utopisë. Djepi, atdheu – Shqipëria, dhe foshnja – pavarësia, shteti janë në tehun e humnerës. Heroi rrëfimtari, alter ego i autorit, zgjat dorën ta tërheqë djepin. Plaku kohë nuk e lejon. Shkëmbi mbyllet. Historia, e nesërmja, ngjarjet dhe rrethanat, dhe jo idealizmi, as individi, do të përcaktojnë nga do të shkojë dhe si do të shkojë Shqipëria.



Tregime me përbërës fantastikë, të marrë nga përrallat me zana dhe ora, do të shkruajë më vonë Ernest Koliqi. Nga brezat e shkrimtarëve pas tij do të shquajnë novela *E madhe është gjëma e mëkatit* (1947/2000) e Mitrush Kutelit dhe romani *Kush e solli Doruntinën* (1980) i Ismail Kadaresë.

Po rikthehem i përsëri te proza poetike *Përpara shegës me lule* për një dukuri tjetër, shenja të kuptimit psikanalitik të unit njerëzor. *Uni* është shkruar tri herë, me *U* të madhe dhe i nënvizuar. Unë, veta e parë, pa shkronjë të madhe dhe i panënvizuar është i njohur prej subjektit përsiatës: *gjendet në zbrazëti, pa mbështetje dhe dhembshuri, pa qëllim, pa një ngrohtësi, ku të zbutet akulli i jetës. Uni me U të madhe dhe shkronja të nënvizuara është labirint, rrjet i ngatërruar kalimesh prej nga mund të dilet me shumë vështirësi dhe kaos, pështjellim i madh, çrregullim i plotë. Përpara tij është i dobët dhe i pafuqi. I mungojnë aftësitë për ta zotëruar. Dhe trembet jo vetëm se nuk e zotëron, por edhe nga përfytyrimi që ka për të: më dukej një gjë e thellë dhe e zezë, si nëndhesat e shtëpive të mëdha, kur isha i vogël. Uni* emërtohet me fjalën e papërcaktuar *gjë*, me dy cilësi konkretizuese: *e thellë dhe e zezë*. E thellë ndërmend nënvetëdijen, e cila është poshtë thellësive të vetëdijes. Po ashtu, *e zezë*, që mund të jetë edhe e errët, e paqartë, e pandriçuar nga drita vetëdijes. Edhe fytyra e motrës së dashur, Mimikës, që më parë nuk gjallonte në mendimet e tij, i shfaqet nga *thellësia e Unit*, ku rrinë të fshehtat e shpirtit. Këtyre u shtohet krahasimi *si nëndhesat*, të përngjashme me nënvetëdijen. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* për nënvetëdijen jep edhe kuptimin: Fusha e mendimeve, e përfytyrimeve, e ndjenjave dhe e gjendjeve psikike jo të qarta, pjesa e turbullt e vetëdijes. Në frëngjisht, nënvetëdijes i thonë *subconscience/ sub-nën* dhe *conscience/ vetëdije*. Për psikanalizën funksioni i *unit* është të zgjidhë konfliktet midis

idit, shtytjeve seksuale dhe *mbi-unit* ndalesave, parimeve morale, pra, midis nënvetëdijes dhe vetëdijes.

Shega me lule bëhet shkak i jashtëm për zbulimin e *Unit* të subjektit përsiatës. Lidhja e rastit, që ka krijuar shkrimtari pa e paramenduar, mes Unit, dukuri psikike, dhe shegës, objekt i natyrës, gjithsesi, shpie në disa domethënie. Në simbolikat e kulturës lindore një nga kuptimet e frutës së shegës është pjellshmëria mëmësore, kuptim që është edhe në kulturën perëndimore. Por, me kristianizmin, druri i shegës ka marrë edhe kuptimin e pjellshmërisë shpirtërore, të bekimit hyjnor, të dashurisë qiellore. Simbolizon edhe priftin e mbushur me dashamirësi. Subjekti përsiatës kalon përpara shegës me lule si para një objekti a qenieje që e adhuron, si para një altari. Nuk është thjesht tërheqja përpara bukurisë së pemës. Ka diçka njerëzore, më të thellë, më të ndjerë ndaj asaj, që ndërldh *Unin* e tij, në zbrazëti e padhembshuri, me Mimikën foshnjë, lule jete e sapoçelur, që i jep fuqi e gëzim, e bën të ketë në zemër një dashuri. Mimika femër është e pranëvënë me lulet e shegës, që do të kthehen në fruta të saj, simbol i pjellshmërisë mëmësore. Mid'hat Frashëri, i shëmbëlltyrë, në tregim, në subjekt përsiatës, ishte mishërim i pjellshmërisë shpirtërore, i predikuesit, priftit apo imamt. Sa e sa të rinj kanë marrë prej tij bekime atdhetarie, idealizmi, kulturore e letrare.

Edhe trauma e Asijes, kushërirës, shihet në këndvështrim psikologjik e psikanalitik, pasojë e mungesës së afeksionit familjar, e cila cilësohet *fatkeqësia më e rëndë për njeriun*.

Proza poetike *Përpara shegës me lule*, e mbetur në dorëshkrim deri dje, ka poshtëshënimin e autorit: *Shkruar herën e parë më 1898-1899 në Eren-Qoj* (Stamboll). Megjithëse në fillim të shekullit XX psikanaliza del nga qarqet e ngushta shkencore, është shumë herët për të hyrë në kulturën shqiptare. Poshtëshënimi: *shkruar herën e parë më 1898-1899*, lë të nënkuptohet se është plotësuar apo rishkruar, ndoshta, kur psikanaliza ishte e njohur në rrethet kulturore e letrare europiane. Përsëri mbetet diçka e vështirë për t'u sqaruar. Përse në një motërzim të kësaj proze poetike, e titulluar *Fytyra e motrës*, me mbishënimin *Athinë, 6 korrik 1923*, mungon, pikërisht, pjesa e Unit?

Për ta shtrirë përafrimin me ndonjë vepër letrare të njohur jashtë kontekstit të letërsisë dhe të kulturës shqiptare të asaj kohe, do të përmendim romanin *Pështjellimet e Tërlesit* (1906) të shkrimtarit austriak Robert Musil, që ka në qendër krizën e zhvillimit individual, konkretisht, zbulimin e unit të heroit adoleshent, që, për arsye të moshës, është ende pa identitet vetjak. Përafrimi i prozës poetike *Përpara shegës me lule* me *Pështjellimet e Tërlesit*, vepër paradigmatisht e letërsisë moderne europiane të fillimshekullit XX, është vetëm për shenjën e modernizmit, sa për të ndërmendur diçka nga klima kulturore në Europë dhe jo për të krijuar ndonjë ide krahasimi, aq më pak barazuese.

Shenja të kuptimit psikanalitik të botës njerëzore ka edhe në proza e shkrime të tjera.

Mid'hat Frashëri – *Dashuria seksuale është pak e përzier me smirë, urrejtje dhe epush, se ai që dashuron vërtet, jep diçka nga jeta e tij*.

Sipas Frojdit, në një tip të dashuruarish, me xhelozinë pasioni arrin kulmin dhe femra fiton vlerën e plotë. Frojdi flet për xhelozinë, gjetiu edhe për urrejtjen dhe sadizmin, në dashurinë seksuale. Mid'hat Frashëri sheh në të përzierjen e smirës, urrejtjes dhe epushit.

Mid'hat Frashëri – *Cili mund ta mobojë që poezia dhe aktiviteti mendor nuk ka një burim tek instinkti seksual i njeriut?* Paaftësia e instinktit seksual për të krijuar kënaqje të plotë, pohon Frojdi, me t'iu nënshtruar kërkesave të kulturës, bëhet burimi i veprimtarisë kulturore më të lartë, e cila kryhet me një sublimim gjithnjë e më të thelluar të komponentëve të tij instinktivë.

Mid'hat Frashëri – *Fytyra e gruas ndërron si qielli dhe si deti. Vetëm dashnori mund ta gjykojë bukurin' e gruas, se ai e sheh në ekstazë; ai njezh vështrimin dhe buzëqeshjen, që i jep asaj dashuria*. Fytyra, pamja e gruas/ femrës ndryshon nga thellësitë e qenies, njëmendësisht nga gjendja hormonale. Bukuria e saj e mirëfilltë, më e madhe, është në ekstazë, në kulmin e kënaqësisë seksuale, prandaj e sheh vetëm i dashuri.

Në mungesë të të dhënave biografike të këtij lloji, nuk mund të themi se Mid'hat Frashëri ka lexuar për psikanalizën a Frojdin. Përshkrimi, disa përcaktime, karakteristika, sidomos përfytyrimi është i ngjashëm me përfytyrimin e kuptimit psikanalitik. Pas këtyre përfaqësive dhe krahasimeve paraprake nuk mund të mos gjenden, se nga dhe si kanë hyrë shenjat dhe përbërësit e modernizmit. Më e qarta është se nuk janë detyruar, së pari, nga realiteti dhe kultura brendashqiptare, por nga kultura moderne perëndimore, e nxënë prej Mid'hat Frashërit, qysh në fillimet e shfaqjes së saj.

PA HERONJ, PA BUJË

Ndriçim Ademaj

Prapë e diel. Jo se ka ndonjë rëndësi të madhe. Sa për të bërë pak muhabet me veten. Nuk më bëhet asgjë. Më shkoi mendja të vras veten. Budallallëk. Shumë dramë për asgjë. Kurrë nuk kam mundur ta kuptoj pse një njeri mund ta vrasë veten. Të gjithë do të vdesim një ditë, kështu që s'kam pse nxitohem bash sot. Kurrë s'i dihet. Diçka sikur po i mungon kësaj dhome. Ndoshta një mace. Më është bërë jeta lëmshe e maceve iu pëlqen të luajnë me lëmshe. Më dhimbset ajo mace që do të jetonte në një vend me mua.

Pela ime prej hekuri rri e heshtur mes një grumbulli biçikletash para hyrjes. Është e vetmja biçikletë që duket e lodhur. Qysh fëmijë kam dashur të kem një biçikletë. Kjo është biçikleta ime e parë. Më kujtohet Xan shkurtabiqi. Njeriu më i mirë i mëhallës sonë. E shikoja çdo ditë si rendte me shpejtësi me biçikletën e tij të hirtë.

Me zor i mbërrinte pedalet. E shtynte me zor pedalin e djathtë dhe e mbante këmbën ashtu në ajër derisa i vinte e majta. E kështu, plot herë të tjera. Rrinte drejt. Duke sikur nuk po mbahej askund. Xani shihte punën e vet. Nuk kërkonte ndihmë prej askujt. E megjithatë, në një vend pallavraxhinjsh është e vështirë të shohësh veç punën tënde. Xani kishte një grua të gjatë. Thoshin se ishte memece. Nuk e ka çdokush këtë fat. Ajo ishte boll e bukur. Të gjithë burrat e mëhallës ia ngulnin sytë. Burra që merreshin me thashetheme gjithë ditën e lume. "Xan, a po mun ia mbërrin?" - i thoshin me tallje kur e shihnin tek kalonte me biçikletë si era. Ai bënte sikur nuk i dëgjonte. - "Xan, a po mun i del në krye". Derisa ia binin në majë të hundës. "Bjere gruen tande, t'kallxoj", - ia kthente ndonjërit. Ai i turrej mbrapa derisa hundët i mbusheshin me pluhur prej rrotave të biçikletës së tij të shpejtë. Me Xanin nuk mund të bëje shumë fjalë.

Dola në rrugë. Gjenevës i kishte rënë mbi krye një mjegull e vrugët. Gjithçka kishte fshehur kokën. Tramvaji i linjës 15 që kalonte pranë rrugës sime dukej si anije e vjetër piratësh. Një anije piratësh në një vend ku piratë guxojnë të jenë vetëm bankierët e mëdhenj. Dy-tri fëmijë bashkë me prindërit e tyre po dilnin nga kisha katolike përballë sheshit *Plainplais*. "Shpëtoji shpirtrat tanë, Jezu", - thirrën njëzëri, me zë të lartë.

Një lypës me flokë dhe mjekër të gjatë ktheu kokën. Nuk e kishin me të. "Mos ua zë për të madhe që ta çajnë kokën dhjetë herë në ditë, Jezu", - pëshpëriti me vete duke buzëqeshur.

Mjegulla u rrinte mirë vendeve të humbura, si qyteti ku jam rritur unë. Atje nuk ndodh asgjë në dimër. Rrugët janë bosh. Njerëzit janë bosh. E vetmja gjë që bën vaki në dimër është vdekja. E ne shihnim se si në rrugicat e ngushta kalonin njerëz të mërëzitur duke mbartur trupin e pajetë të ndonjë familjari të tyre mbi supe. Nja gjashtë, tetë, dhjetë veta që ndërroreshin mes vedi gjithë kohës. Pas tyre një turmë e vogël njerëzish ecnin në heshtje për ta përcjellë drejt varrezave në fund të qytetit. Ndonjëri mendohej të tallej me ndonjë tjetër. Por kot. Edhe shakatë më të goditura shkojnë dëm kur vdes dikush.

Liqeni nuk dukej pothuajse fare. E vetmja gjë që shoh është rrota e parë e biçikletës sime *Peugeot* që çan rrugën si pulë pa krye. Zbrita dhe fillova të eci nëpër lagjen *Paquis*. U futa në Rrugën e Bernës.

Më kujtohet fort mirë kur kam ardhur për herë të parë në Gjenevë. Askujt nuk i hante për një njeri më tepër që kalonte rrugës. Në Ballkan, njerëzit mendojnë se femrat e Perëndimit shkojnë me çdo mashkull që iu del përpara, ndërsa te ne duhet t'u shkosh mbrapa nja tre muaj për të nxjerrë diçka në dritë. Atëkohë, kisha disa muaj që kisha ardhur në Perëndim dhe nuk kisha takuar asnjëherë nga ato femra për të cilat flisnin burrat e Ballkanit. Derisa një ditë më ra udha këndeje, nga Rruga e Bernës. Femra e parë filloi të më buzëqeshte dhe po më fliste diçka. Aty më erdhi fytyra. E dyta mbas saj po më thërriste me gishtin tregues. E harrova të parën dhe u afrova tek ajo tjetra. Aty pashë një të tretë, nga ana tjetër e rrugës. Një çokollatë e gjatë dhe e hijshme. Zot i madh! Ishte dita ime. Xhim tutkuni, mbreti i Rrugës së Bernës. Ëndrra e femrave të hijshme me taka të larta. Mbylla sytë dhe fillova ta përfytyroja veten në një shtëpi të madhe me shumë dhoma. Me gjithë këto hyjnesha brenda. Kaloja nga një dhomë në tjetrën. U buzëqeshja. Ua lëmoja flokët dhe dilja. Nuk dija me cilën të shkoja më përpara. Të gjitha më dëshironin. I dëshiroja njëren më shumë se tjetrën. Çfarë jete e trentë!

Ndriçim Ademaj
Pa heronj, pa bujë
Roman



BOTIME



- Si e ke emrin, zemër? - i thashë asaj që po më thërriste me gishtin tregues.

- Njoqinfranke! - ma ktheu duke kafshuar buzën.

- Njëqindfranga!

- Po, njoqinfranke!

- Paske emër të shtrenjtë, zemër. Shkojmë e pimë nga një, Njëqindfranga?

- Njoqinfranke!

Para nesh u ndal një burrë nja 60 vjeç. Atij nuk i interesante emri i saj. Ia bëri me shenjë dhe ajo filloi të ecë para, ky mbas. U futën në një derë të ngushtë përballë. Më erdhi për të vjellë. Sa herë kaloj këndeje më vjen për të vjellë. I hipa pelës sime prej hekuri dhe u nisa për në shtëpi...

Qielli mbante erë nate e terr nuk ishte ende. Tramvajet kryqëzoheshin me njëri-tjetrin si lojtarë futbollit që merren vesh fort mirë mes tyre. Në këtë qytet nuk vrapon askush. Edhe ambulancat presin dritën e gjelbër në semafor. Më shkoi mendja tek ai poeti i hamamtë. M'u zu fryma. U mundova t'i jap biçikletës sa më shpejt që munda. Ndoshta nuk do të ishte keq që në numrin e ditës së nesërme të "Tribune de Geneve" të kishte një titull si "një veturë përplasi për vdekje një biçiklist që po ngiste në kah të kundërt", ose diçka të tillë. Njëra nga plakat e këtij qyteti do të thoshte: "I gjori djalë." Shojja e saj do t'ia kthente: "Rregullat janë bërë për t'u respektuar."

Kalova nëpër Rrugën e Sinagogës dhe para një librerie të vogël pranë saj. Në pidh të sëmës Sara! Nuk duhet të jetë edhe aq e vështirë të jetohet pa fytyrën tënde tinëzare. Gjithë çka paskësh ndodhur mes meje e asaj, ne dy anët e asaj dërrase të vjetër, paskësh qenë një gënjeshtër e madhe. Edhe ato gota që bënte sikur m'i qeraste fshehtas Henrit, klientët që i përbuzte para meje, lotët e saj kokërr tek këndonte Billie Holiday-n, getat e grisura. Gjithçka paskësh qenë një fluskë sapuni mbi trupin e një njeriu që po lahet për herë të parë në jetë. Nëse kam mundur të mbijetoj gjithë këto kohë pa fytyrën e nënës sime të dëlirë, pa ty do të jetë si bukë me djathë. E për sherr, armiku më i madh i kujtesës është nostalgjia...

Po më ushtojnë veshët. Rruga po më duket si harmonikë në duart e një të dehuri. Kalova mepërmes sheshit *Plainpalais* dhe hyra në kah të kundërt. Dëgjoja sirenat e veturave dhe kujën e rrotave të zeza që rrëshqisnin mbi asfalt. Ndieja kundërmimin e frenave të tyre para hundës sime. S'paska pasur një njeri të zotë në këtë qytet që të frenojë nja dy sekonda me vonesë. U futa në rrugicën time. Para derës së hyrjes rrinte një vajzë. Më duket se banonte aty. Lidha biçikletën dhe u nisa për nga dera. Ajo nuk po m'i hiqte sytë.

Pjesë nga romani "Pa heronj, pa bujë",
botimet "Pegi", 2017



ZOTI ZBRET MBI JASEMINË

Poezi nga Shqiponja Axhami

MBI HIRIN E NJË ZJARRI

Çdo ditë nis e shkruaj
mbi hirin e një zjarri
sytë e një feniksi.
Nuk ka rëndësi të trembesh;
Dantja sheqeros kafkat e Ferrit
me lëng boronicash;
pylli iu dorëzua etjes,
një Zot i gjelbërt numëron
mëkatarët si gjethet,
druvarët pikturojnë
mbi fetusin e florinjte
forma trëndafilash.
Tani mos më lexo më,
po shuaji qirinjtë:
lutja mbaroi. Duaje
deri në shënjtërim
të dritësimit terrin:
trëndafila,
trëndafila,
trëndafila
mbijnë...



MBRËMJE

Mbrëmje.
këmbët kanë ftohtë,
kërkojnë udhë të reja;
rrethinat flenë nën një gjumë pikëllues;
duhet patjetër të jesh në udhëtim
që t'i japësh formë idesë.
Mbrëmje...

Mbi varreza të gjallët vënë karamela...



QENIE TË VOGLA NA VËSHTROJNË

Ka qenie të vogla që na vështrojnë:
janë lulet e padukshme të erës;
me sy të vegjël, me gojë të vogël,
me kërshtërinë e madhe
që të na imitojnë.

Erërat puthen,
erërat dashurohen,
erërat çmenden.....
.....
erërat urrejnë shtëpitë.

GJITHÇKA, POSTEJE

Në mes të asgjësë
kam zgjedhur tufën e demave,
pluhurin e fushës,
boçet e pishës
që bien mbi çati,
një gështejnë në krisje,
mështeknat,
farin që zhytet
në sytë e peshqve të kuq,
midhjen
në mes të asgjësë.
Gjithçka mund të zgjidhet,
Pos teje ...
E gjithë kjo mungesë,
është një gogol i madh
me sytë e hiçit.



ÇASTI I KTHINTË

Nuk më tremb
çasti i kthintë
kur një shën Thoma,
në emër të fatit,
shkul pendë shqiponje.

Sepse jam e bindur:
lart është gjithmonë
një fole me vezë në krisje
në emër të dëshirës.

BRENDA TEJE

e kështu, brenda teje
shkëlqen koral i një zanafille,
krijohet një lagunë,
prehen mbi të mëllenja -
zbresin me saksonë mbi buzë
një kor muzikantësh,
shkelin mbi jaseminë.
xhazi i tyre zbut
përvijimet e errta të brigjeve,
hapet kuverta e ndrojtës,
përshkon një udhë
rreshtin e saksive... lule
dyer... dyer
fjolla levandoje,
kupola pasioni,
pak kaos,
vibrime drite -
fundi vishet mbi një trung palme
si një dëshirim i përhimtë -
e papërcaktuara me sytë e revoltës
lëshuar mbi telat e një lahute
që i këndon gjithsesi vazhdimësisë...



KUR AJO NATË...

Kur ajo natë do vijë,
ne do rendim mbi limanin e vetmisë
si mbi një delfin të bindur;
do pimë në barin e braktisur
ku pi birrën e falur një i pastrehë;
do shëtisim nëpër stacionin e trenave
ku një poet gris fletë ditari; në harresë
do ushqehemi me naivitetin e natës;
do zbukurojmë fytyrat e njëri-tjetrit
me devotshmërinë e rënies së yjeve
do mbulojmë sytë e përbotur me lulka bliri
kur ajo natë të vijë...
ne të dy do ta kthejmë qytetin në frut...



KRIZANTEMË...

E kështu, renda
ishull më ishull...
ku piqeshin mbi zjarr dëllinje
kuleçë për të denjë,
me shijen e hirit në gojë.
U jam përgjigjur
korit të gënjeshtarëve
matanë, në bregun e humusit,
ku boçja e pambukur nuk bëhej
rrobë të varfërisë...
Jam besimtare e lirisë,
e asaj lirie që vjen me sy foshnjash
dhe me duart plot fruta,
ndaj naiviteti im
kërkon të falë...
Së fundmi
harkohem në vendin tim
si një harpë e vogël,
përgatitur për ditë të mëdha,
ku lëkurat e lumenjve
do më veshin me rrobën e krizantemte
të një mbretërimi të paqtë,
të mitizimit të asgjësë së nëpërkëmbur...

“STREHA MES REVE”

FILMI SHQIPTAR SHPALLET MË I MIRI NË VALLETTA FILM FESTIVAL

Pa u mbushur një vit nga premiera në kinemanë shqiptare, filmi i regjisorit Robert Budina, “Streha mes reve”, sapo është shpallur filmi më i mirë në Valletta Film Festival me motivin: “*Streha mes reve*” – për qasjen delikate të një subjekti të ndjeshëm për kohët që jetojmë, bashkekzistencën paqësore mes katolicizmit dhe islamizmit, në sfondin kinematografik të maleve shqiptare. “Doja të realizoja një film intim, personal, të realizmit magjik në kufijtë e përrallës ku koha ka ndaluar dhe historia jonë mund të ketë ndodhur, ndodh ose do të ndodhë. Kjo ngjarje nuk mund të ndodhte veç mes malesh dhe natyrës së vërtetë, virgjërisë, bukurisë, pastërtisë, qetësisë, aty ku e ka origjinën njeriu dhe ku ka lindur historia e tij”, – është shprehur pak kohë më parë regjisor Robert Budina, i cili e ka xhiruar atë në Luginën e Valbonës dhe Dragobisë.

Feja, familja dhe dashuria në Shqipërinë e thellë rurale. Në një formë jotradicionale trajtohen sa thjesht në dukje, aq edhe në formë të pazakontë, në filmin “Streha mes reve”. Në një fshat të thellë në Veri të Shqipërisë banorët pranojnë atë që në asnjë vend në botë nuk ndodh, të ndajnë mes tyre një xhami-kishë të përbashkët. Besniku (në rol Arben Bajraktaraj) jeton në këtë mal të thepisur së bashku me familjen e tij. Por, bota e tij është vetmia e tij, që e gjen në kishën-xhami, edhe mes dhive. “Vështirësia më e madhe ishte që të thuresha me Besnikun, sepse ai kalonte, si nga ana e fesë, familjes dhe dashurisë, në një vetmi, në një humbje. Dalëngadalë e gjen veten. Gjatë xhirimeve kam qenë në të njëjtën kohë edhe i shqetësuar edhe i lumtur, sepse personazhi mbante një lloj trazimi, jo trazim i vuajtjes, por të një misterit të pakapshëm, që vetë Valbona na i sjell këtë”, – është shprehur për mediat Arben Bajraktaraj.

I ati i Besnikut (Bruno Shllaku), një mysliman dhe komunist; Albani, vëllai i tij, është ortodoks; nëna e tij sa ishte gjallë lutej fshehtas, se ishte katolike; ndërsa Besniku është ndaluar nga i ati që të martohet me vajzën që ka dashur për shkak të politikës së kohës.

Ndërsa aktori Bruno Shllaku me rastin e premierës së filmit ka thënë: “Kjo është një dramë e përbotshme, sepse përherë kur kanë hyrë në tunelin e vdekjes të zotët e shtëpive, fillon mërmëritja e nëndheshme dhe e mbidheshme. Roli im është një rol i komplikuar, sepse ke të bësh me tri komunitetet fetare brenda familjes. Për

të arritur në konkluzionin që ta bashkosh këtë familje, ishte shumë e vështirë... Në të vërtetë, janë mjeranë ata që shkatërrohen me njeriun dhe gjakun e vet, për dy kokë dhi, dy tulla, qoftë edhe për dy milionë euro.”

Gërvishtja e murit të xhamisë nga Besniku, ku do të zbulonte muralen katolike, është një nga momentet më kyçe të këtij filmi. Dy specialistet e dërguara të Institutit të Monumenteve vërtetojnë se xhamia deri më 1470 kishte qenë kishë...

Më në fund, Streha erdhi në shtëpi të vet, pres që audienca ta presë. Një film që flet për njerëz, virtyte edhe trauma, por edhe virtyte shqiptare. Momenti që më pëlqen më shumë, është momenti kur Besniku shikon nga kamera dhe zbulohet muralja. Është një kapriço regjisoriale shumë e fortë. Deri tani kemi marrë dhjetë ftesa nga festivale ndërkombëtare, në kompeticione zyrtare.

Edhe pas zbulimit se xhamia e vjetër e fshatit ishte një kishë dhe se ndërtesa ishte në të vërtetë e ndarë nga dy fetë në të kaluarën, qetësia e jetës së përditshme mund të ruhet vetëm me ndihmën e Besnikut. Megjithatë, pas vdekjes së babait të tij, ndryshimet drastike kërcënojnë familjen e Besnikut dhe bariu është i detyruar të krijojë rrugën e tij.

Filmi është financuar nga QKK dhe është prodhuar nga producentja Sabina Kodra (Era film) në bashkëprodhim me RTSH dhe Cristian Nicolescu, Rumani (Digital Cube). “Streha mes reve” u xhirua nga drejtori i fotografisë së Radu Jude, Marius Panduru (i cili gjithashtu ka xhiruar filmin “Album”, triumfues në festivalin e filmit të Sarajevës më 2014), montazhier Ștefan Tatu (Ëolf) dhe kompozitor Marius Leftărache. Kasti filmik përbëhet po ashtu nga Esela Pysqyli, Irena Cahani, Bruno Shllaku dhe Osman Ahmeti dhe të drejtat ndërkombëtare trajtohen nga distribucioni gjerman i Pluto Film. Deri tani ky produksion shqiptar është përfshirë në shumë kompeticione ndërkombëtare, ku dhe ka reaguar kritika duke i kushtuar vëmendje personalitetit dhe ofertës gjeografike që jep filmi. Është nga rastet e pakta që kinematografia shqiptare krijon një marrëdhënie ekzistenciale mes individit dhe natyrës, duke zbuluar atë që është thellësisht psikologji dhe dramë e projektuar profesionalisht, edhe pse sfondi mban religjionin si një nga debatet që ka ndjekur shoqëritë në këtë shekull.

“NA ISHTE NJËHERË SHPRESA” BOTOHET NË FINLANDË ANTOLOGJIA E POEZISË BASHKËKOHORE SHQIPTARE

Nga data 13 deri më 16 qershor 2019, në qytetet finlandeze Tampere dhe Lahti u përrua antologjia më e re e poezisë shqiptare në finlandisht. Titulli i antologjisë është “Na ishte njëherë shpresa”, në gjuhën finlandeze “Olipa kerran toivo”. Kjo antologji u përkthye nga origjinali nga Silvana Berki dhe u botua nga “Aviador Kustannus”, me asistencën profesionale të shkrimtarit Aleksanteri Kovalainen dhe kujdesin në botim të Vesa Tompurit.

Kjo antologji me titull domethënës ka bërë bashkë 25 poetë bashkëkohorë shqiptarë që shkruajnë në gjuhën shqipe, pavarësisht nga vendi në të cilin jetojnë. Në veprimtari, përveç dashamirësve të poezisë, morën pjesë edhe emra të shquar të poezisë bashkëkohore finlandeze, si akademikët Kristi Kuuronen, Kari Aaronpuno, si dhe poetë e prozatorë, si Hannu Luntiala apo poetja Saara Metsäranta. Parathënien e antologjisë, kushtuar kryesisht gjuhës shqipe, historikut të saj dhe poezisë shqipe, e ka shkruar poeti dhe studiuesi Gazmend Krasniqi, i cili zbardh për lexuesin finlandez momente të spikatura në poezinë shqiptare, që prej fillimeve të saj e deri në ditët e sotme. Përveç përzgjedhjes mbi kritere profesionale të autorëve dhe shënimeve shoqëruese



për çdo autor, antologjia *Olipa kerran toivo* merr vlerë të veçantë edhe për organizimin veçantë të lëndës letrare. Kjo pasi në këtë antologji, si rrallëherë më parë, bota poetike e shqiptarëve vjen e unifikuar në një panoramë të gjerë e gjithëpërfshirëse. Në brendi të saj ka poetë të trevave ku poezia shkruhet shqip, duke filluar nga poezia bashkëkohore që shkruhet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, në Mal i Zi dhe tek arbëreshët e Italisë. Prezent në takim, një paraqitje të tillë poeti Arian Leka e cilësoi si një hartë poetike për të mbërritur në viset e shpirtit shqiptar, por edhe një udhërrëfyes ku, përveç peizazhit me lumenj e me dete, me male e me qytete, shfaqen edhe relievet e historisë dhe shqiptarit. Ideja e një projekti mbi antologjinë *Olipa kerran toivo* filloi tre vjet më parë. Emrat e poetëve të përfshirë në të janë: Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Xhevahir Spahiu, Fatos Arapi, Mimoza Ahmeti, Suzana Zisi, Luljeta Lleshanaku, Agron Tufa, Sokol Zekaj, Gazmend Krasniqi, Adem Gashi, Ndue Ukaj, Sabri Hamiti, Kujtim Shala, Ramadan Musliu, Selajdin Saliu, Eqrem Basha, Xhevdet Bajraj, Anton Gjojcaj, Marg Shilipa, Zef Skiro Di Maxho, Mario Belizzi, Katerina Xukaro, Lindita Ahmeti dhe Lulëzim Haziri.



Shtëpia Botuese Onufri së shpejti në të gjitha libraritë e vendit me romanin befasues të Ylljet Aliçkajt, ku “tregohet” përditshmëria e jetës rutinë të një kryeqyteti nën diktaturë dhe postdiktaturë, si një laborator i natyrës njerëzore

“METAMORFOZA E NJË KRYEQYTETI” ROMANI I RI I YLLJET ALIÇKAJT

*A*ty nga fundi i vitit 1990, poeti i njohur Beniamin Bendo hyri në periudhën më trimërore të krijimtarisë së tij, atë të disidencës së hapur kundër regjimit, koincidence e pastër kjo me kohën kur vetë regjimi komunist po përjetonte grabmat e fundit dhe gradualisht, po shkohej drejt një zbrazëtie pushteti. Pa e ditur as vetë se po bënte trimëri, atë natë kur studentët e revoltuar hynë në grevë urie, Beniamini shkroi një poezi disidente me metafora të natyrës gjeografike. Pranohet, jeta e poetëve është plot të papritura. Dikush mund të hedhë dyshimin se ndoshta kjo kthesë poetike iu imponua nga rrethanat. Jo, kjo ndodhi ngaqë ato kohë poeti po kalonte një fazë trimërie, sado që, pse të mos e themi, trimëri me hope. Thënë ndryshe, po që se nuk i dilnin përpara pengesa të pakapërcyeshme, ai burrë hidhej aty ku ndodhej rreziku.

Nuk mund të thuash me siguri nëse ai ishte trim apo frikacak. Ndoshta i kishte të dyja dhe me gjasë, as ai vetë nuk e dinte këtë gjë. Të paktën, këtë përshtypje të krijonin luhatjet e muzës së tij.

Ky përshkrim kaq personal, edhe pse është në vetën e tretë, krijon reminiscencë të lexuesit shqiptar, por për një tjetër nis menjëherë shqetësimi i brendshëm çfarë do të ndodhë me Beniamin Bendon, poetin e njohur që përmbys papritur muzën në çastet e fundit të rënies së komunizmit me fatin e kryeqytetit të “përmbysur”... Me ironi të drejtpërdrejtë, shkrimtari Ylljet Aliçka nis romanin e ri “Metamorfoza e një kryeqyteti”, që së shpejti do të jetë në të gjitha libraritë nga Botimet Onufri. Në prag të daljes së romanit, shkrimtari Ylljet Aliçka shprehet: “Një kryeqytet në diktaturë ka vlerat dhe antivlerat përkatëse, që e dallojnë atë nga po ky kryeqytet në mungesë diktature, ...mbart shenjat përkatëse në përditshmërinë, mendimet, sjelljet, referencat e saj intelektuale, kulturore dhe mënyrën e jetesës së kryeqytetasve, duke kushtëzuar frymën dhe shpirtin e qytetarëve të saj.”

Lexuesit e parë në dorëshkrim e kanë vlerësuar romanin si një nga prurjet më të befta në letërsi. Një prej tyre, shkrimtari Visar Zhiti, thotë: “Romani më i ri i shkrimtarit Ylljet Aliçka, *Metamorfoza e një kryeqyteti*, është me të vërtetë i ri për prurjet dhe të shkruarin, ku ngërthehen ndryshimet e befta sociale me humorin gri, ngjarjet që duket sikur mbërrijnë deri në çastin që po lexojmë, me personazhe që na ngjajnë se i njohim, aq sa mëdyshe mi se mos janë vetvetet tona të maskuara. Çështjet që shpalos, realizmi çehovian, ironia e pamëshirshme ndaj alienimeve dhe shtirjeve, stili i veçantë e shpotitës etj., e çojnë këtë roman mes arritjeve më të mira të të gjitha botimeve në letërsinë e postdiktaturës, kohë e cila bën antiheronj dhe që ata me groteskun e tyre e zhbëjnë. Po, po, dëshmohej këtu me një buzgaz të dëshpëruar.”

Objekt i këtij romani janë përditshmëritë e jetës rutinë të një kryeqyteti nën diktaturë dhe postdiktaturë: si një laborator i natyrës njerëzore. Një kryeqytet në diktaturë ka vlerat dhe antivlerat përkatëse, që e dallojnë atë nga po ky kryeqytet në mungesë diktature, mbart shenjat përkatëse në përditshmërinë, mendimet, sjelljet,



“

Romani më i ri i shkrimtarit Ylljet Aliçka, *Metamorfoza e një kryeqyteti*, është me të vërtetë i ri për prurjet dhe të shkruarin, ku ngërthehen ndryshimet e befta sociale me humorin gri, ngjarjet që duket sikur mbërrijnë deri në çastin që po lexojmë, me personazhe që na ngjajnë se i njohim, aq sa mëdyshe mi se mos janë vetvetet tona të maskuara.

referencat e saj intelektuale, kulturore dhe mënyrën e jetesës së kryeqytetasve, duke kushtëzuar frymën dhe shpirtin e qytetarëve të saj.

Me ndryshimin e kohërave, ndryshuan edhe ndjesitë apo perceptimet e lumturisë. Më shumë se e kushtëzuar nga mungesa apo turrjet e dëshirave në përgjithësi, lumturia apo dëshpërimi i kryeqytetasve, si në komunizëm ashtu dhe pas rënies së tij, u përcaktua nga dallimet mes qenieve njerëzore në rrethana të caktuara kohe e vendi, në detaje gati të parëndësishme në dukje, por që e lumturonin pandërgjegjshëm individin me biografi të mirë dhe që ndofta sot e bëjnë të ndiejë nostalgji për atë kohë.

Tronditjet e thella të rendit politik, bie fjala, ato që pasuan rënien e murit të Berlinit, në Tiranë u shoqëruan me ndryshime jo vetëm të nivelit politiko-ekonomik, por edhe me rishikime e rivendosje hierarkish sociale, tronditje shpirtërore-fetare, me ndryshim vlerash, sepse sa më e ashpër të ketë qenë diktatura, pra deformimi apo formimi i “njeriut të ri”, aq më i vështirë është orientimi në realitetet e reja dhe rivendosja e normave të reja. Përditshmëria dhe evolucioni i personazheve të këtij romani “zbulon” se deri ku shkon nënshtrimi, kuraja dhe dhunimi i njeriut, ndjekur nga çorientimi shpirtëror që pasoi rënien e komunizmit, me boshllëkun përkatës të vlerave, duke u bërë shkak i shfaqjeve të identiteteve fiktive të improvizuara të shumë njerëz.

“Metamorfoza e një kryeqyteti” shtjellon evolucionin e jetës së një galerie personazhesh, në situata të ndryshme

të jetës së tyre, kryesisht nga një familje e njohur tiranase (poet, veteran, diplomat, i ri eurosocialist, biznesmen) dhe më gjerë (Udhëheqësi komunist, shefi i shërbimeve sekrete, skulptori, i burgosuri politik), nga jeta e tyre në komunizëm deri në realitetet e reja postdiktatoriale, bazuar kryesisht në dukuritë shpirtërore e ato të personalitetit, si fenomenet e nënshtrimit, mbizotërimit, poshtërimit, deformimit, parë këto nën një këndvështrim ironik, deri në nivelin e sarkazmit (incidenti politik i një poeti dhe ndryshimi i metaforave artistike me natyrë politike, rituali i falënderimit ndaj Udhëheqësit komunist nga ana e të dënuarve me vdekje para pushkatimit, jeta shpirtërore e një diplomati dhe shndërrimi i tij në një biznesmen, incidenti me fytyrën e Udhëheqësit të vdekur gjatë përgatitjes së maskës prej allçie, shndërrimi i komunistëve në eurosocialistë...). Romani “Metamorfoza e një kryeqyteti” ishte një nga librat pretendentë për çmimin “Kadare 2019”, të cilin shkrimtari Mehmet Kraja, në cilësinë e një prej anëtarëve të jurisë, ka dhënë këtë vlerësim: “Përmes një parodie të drejtpërdrejtë, e cila merr trajtë me anë të një përpunimi të mjaftueshëm artistik, janë përmbledhur në një vend rrëfimet “popullore” për periudhën e vonë të diktaturës dhe “rrëshqitjen” e saj graduale në demokracinë kaotike. Ndonëse ndonjëherë ngjan sipërfaqësor, autori arrin t’i shmanget trajtimit publicistik dhe humorit të përciptë, duke sjellë për lexuesin një vepër të qëndrueshme artistike, me angazhime dhe refleksione aktuale dhe bashkëkohore.”

Fotoja historike e shkrepur në Shkodër, më 16 shkurt të vitit 1938, lidhet me një ngjarje të rrallë: ardhja e Asdrenit në Shqipëri dhe pritja, së bashku me Lasgush Poradecin, me festime treditore në Shkodër. Foton e ka publikuar fillimisht e bija e Lasgush Poradecit, nxjerrë nga arkivi i poetit, ku ruhej prej 80 vjetësh. Ndërsa gazeta e kohës, “Drita” e marrë nga Biblioteka Kombëtare, jep kronikën e plotë të pritjes madhështore që iu bë Asdrenit e Lasgushit, si dhe fjalimin prekës që mbajti Atë Gjergj Fishta. Fotoja mban firmën e studios së Marubëve...

1938/ ASDRENI E LASGUSHI NË SHKODËR PRITJA MADHËSHTORE ME BANDË MUZIKORE DHE FJALIMI PREKËS I FISHTËS

Nga Violeta Murati



Enigma e një fotoje të shkrepur në Shkodër nga Marubët, më 16 shkurt të vitit 1938, lidhet me një ngjarje të rrallë, historike për kulturën. Është një foto ekskluzive në “çajin e profesorëve të Gjymnazit Shkodër”. Fotoja fillimisht është publikuar para pak kohësh nga e bija e Lasgush Poradecit, nxjerrë nga arkivi i poetit, ku ruhej prej 80 vjetësh.

Historia duket e thjeshtë: Asdreni, i plakur tashmë, po vinte për një vizitë në Shqipëri, i ftuar në Shkodër nga shoqëria e arteve të bukura “Rozafat”, të cilit iu bashkua edhe Lasgush Poradeci. Për nder të kësaj vizite u organizuan tri ditë festime. Shtypi i kohës e ka pasqyruar gjerësisht këtë ngjarje, udhëtimin e dy poetëve në Shkodër, duke u pritur “me shfaqje të nxehta simpatie e admirimi”. Para një publiku jashtëzakonisht të dendur, në sallën e kinema “Rozafat”, Atë Gjergj Fishta u dha mirëseardhjen dy poetëve toskë, duke mbajtur një fjalim të jashtëzakonshëm. Në fund: Përqafim patetik, me lot e fjalë ngashëryese nga Asdreni, duke prekur gjithë popullatën e mbledhur në nderim të tij.

Fotoja dhe kronika e ngjarjes publikohet në “Përpjekja” e Branko Merxhanit, si dhe në gazetën “Drita”, në këtë të fundit del një botim i posaçëm, me foton e rrallë të Fishtës gjatë ligjëratës për Asdrenin, të gjendur në Bibliotekën Kombëtare, bërë nga Marubët.

Në grupin e të ftuarve që dhanë koncert, ishte edhe sopranoja Tefta Tashko Koço, si dhe pianistja Lola Aleksi, të dyja personalitete të kohës, të cilat, në nderim të Asdrenit, luajtën për herë të parë pjesë nga opera “Traviata”.

Shoqëria “Rozafat” ishte bujtësja e personaliteteve, e cila kishte 20 vjet jetë, dhe pak ditë para kësaj ngjarjeje kishte kremtuar 20-vjetorin e themelimit të saj, duke shënuar një rast unik në Shqipëri, për kontributin në artet e bukura, pothuaj në të gjitha fushat.

Por, nxitur nga përmbajtja e fotos, prej ku zbardhet kronika e kësaj ngjarjeje, një tjetër personazh historik, drejtor e mësues i gjymnazit të Shkodrës, Gasper Ljarja, bën një organizim të befasishëm duke nxjerrë në rrugë bandën e Shkodrës së asaj kohe, për të nderuar dhe për të pritur Asdrenin e Lasgushin. Këta dy poetë nuk ishin rastësisht së bashku në udhëtimin e Shkodrës. Çfarë dallon në këto marrëdhënie të viteve ’30, është vlerësimi dhe koshienca për vlerat e këtyre personaliteteve, duke i nderuar në kohë reale. Asdrenin dhe Lasgushin e lidhte një miqësi e jashtëzakonshme, ku njihemi se Asdreni e ka ndihmuar kur ai kishte vështirësi financiare gjatë studimeve në Austri, si rezultat i mosdërgimit të bursës.

Por viti kur Asdreni u ftua në Shqipëri, ardhur nga Bukureshti, me nismën e Koliqit, ministër Arsimit në këtë kohë, përkonte me kremtimet e 25-vjetorit të

shtetit shqiptar, dhe ishte një kujdesje e posaçme e shtetit shqiptar për dy poetët.

Më poshtë botojmë të plotë kronikën e ngjarjes, çfarë ndodhi në kinema “Rozafa” më 1938, botuar në gazetën “Drita”, e përditshme nacionale, si një numër i posaçëm më 13 shkurt.



Në çajin e profesorëve të gjymnazit në Shkodër, shkurt 1938

ÇFAQJE ARTISTIKE PËR NDER TË VJERSHËTORIT PLAK, Z. ALEKSANDËR DRENOVA

Shkodër, 13-Sikur e dini, kemi tash një javë në mes t’onë atdhetarin e vjershtarit plak, zotit Aleksandër Drenovën (Asdren), i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë një idhull

(idol) i atdhetarëve, jo vetëm të Shkodrës, por i të tanë Shqipnis. Pse, jeta e Asdrenit, është një brilant që shkëlqen madhnueshëm ndër virtyte e vepra atdhetarije, sikur e vërtetojnë botimet e tija krejt urti e flakë dashunije për atdhe. Qarqet e Shkodrës, pra intelektuale-patriotike, ndijnë një gëzim të jashtëzakonshëm që kanë pasun fatin e mirë t’i shohin syt e t’i ndigjojnë kuvendin këtij

atdhetari letrar. Dhe kët gëzim e kënaqë të posatshme e provojnë prej se:

a) Asdreni që ndër puntorët ma të parë të shvillimit t’ides kombëtare, është një veteran prandej në kuptimin ma të këthellë që ka fjala;

b) Asdreni nderoi përherë secilën vepër që qe në dobi t’atdheut pa u tërhjekë prej kurrnjë pasioni dhe pa

12 FRUER 1938

SHOQËRIA “ROZAFAT”, UNIKE. KREMTON 20-VJETORIN E THEMELIT

Ndërsa tri ditë më parë shoqëria e arteve të bukura “Rozafat” kishte kremtuar 20-vjetorin e krijimit. Po në këtë gazetë është një shënim që flet për këtë kremtim të shoqërisë kulturore, ndoshta nga më të vjetrat dhe me më aktivitet në Shkodër.

“Njizet vjetë jetë të njëj shoqërie kulturele në vendin t’onë, si kur dihet, është një gja krejt e rrallë, mbasi në fushën e shoqërive të tilla, metaforikisht tue folun, shohim përgjithësisht eshtna shoqnish që kanë dhanë shpirt pas pakë kohe të lindjes së tyne. Shoqnija “Rozafat” e Shkodrës, i ngjanë njëj oasi në mes të njëj shkretitje për çka u përket veprimeve të privatëve për zhvillimin e mjeteve kulturele, një oas

ku shikohet fladi e fryma e vëllaznimit të vërtetë dhe ku është i gjallë dhe i fuqishëm vullneti e dëshiri i përparimit. Asht e vërtetë se Shoqnija “Rozafat” nuk ka krye punë të mëdha të dukëshme; por duhet marrë parasysh se misjoni që ka të shënuem edhe në statut, është përhapja dhe përkrahja e shvillimit të harteve të bukura. Dhe ket misjon, shoqnija për të cilën jemi tue folë, e ka krye me kënaqë tëplotë t’atyne që kanë marrë dhe vazhdojnë të marrin pjesë në kët shoqni. Pse, harti muzikuer, o ma mirë të thomi pasion për muzikë, nëpër mjet të veprimt e të propagandës së kësaj shoqërie ka marrë një shvilim të çquem sidomos në djelmënin shkodrane. Numur i math djelmsh mësohen në ndonji vegël muzike në Shoqnin “Rozafat” dhe kanë të gjitha përkrahjet për t’u perfeksionue sa ma mirë. Në dramatikë mandej veprohet sistematikisht tue organizue çfaqjeje e botime të mira. Po gjithashtu është veprue për



Shkodër, shkurt 1938: Nga e majta, Lola Gjoka, Ernest Koliqi, Tefta Tashko, Asdreni (Aleksandër Stavre Drenova), Lasgush Poradeci

vështre se çelsi a misjoni kishte në jetë ai q e kryente;


c) Asdreni qëndroi përherë larg ndërlikimesh e kundërshtimesh të pjelluna përgjithësisht prej rase a nakari.

Në fund Asdreni, tërheqë të gjitha zemrat e atdhetarëve të mirë e të drejtë, pse asht urtoja apo modestija e mishnueme.

Të gjitha këto arsye e shtynë Shoqnin e Hartëve të bukura të Shkodrës “Rozafat”, të bajnë të vetin dishirin e intelektualve dhe atdhetarve të qytetit t’onë për t’i çfaqun këtij patrioti letrar, me anën e njëj manifestale publike e të çqueme, nderimin e miradijen për shërbimet q i ka bamë kombësisë.

Edhe, të shtundën në mëngjes më 12 të këtij moji, mbas një vendimi q mirrte Këshilli i Shoqnisë “Rozafat” dhe përgatitjeve të para q bante, i çpallte popullit të Shkodrës se, për nderë t’Aleksandër Drenovës, po ipte, në sallën e Kinemas “Rozafat” një koncert me anën e orkestrës së saj, tue marrë pjesë edhe artistët shqiptarë, Zojushat Tashko e Aleks. Çpallja njofonte edhe se poeti kombëtar, At Fishta do të hapte çfaqjen artistike me një ligjëratë të tij simpatihje ndaj Mikut e çquem q i ka urdhnuë në Shkodër.

Menjëherë pas kësaj çpallje, të gjitha lozhat, parterre dhe galeritë e kinemas “Rozafat”, u kaparuan. Në kohën kur po fillonte koncerti, s’kishte jo vend për të ndejun, por as një pllambë shesh për të lëvizë. Publiku pothuej as frymë nuk mirrte me kaqë respekt e urti qëndronte. Të dukej sikur t’ishe në një tempull e jo në një sallë theatric. Vetëm, kur merrriten poetent Fishta, Asdreni, Lasgushi e Ernesti, për të cilët ish rezervue një lozhë e posatshme pranë palkit, shpërthyen duertrokitjet në të katër anët.



pikturë tue ngjallun e rëndue ekspozita me çmime inkurajuese. E mbi këto Shoqnija “Rozafat” me koncertet e saja e manifestime artistike dhe argtuese, i ka zbardhun faqen jo vetëm qytetit të Shkodrës, por edhe të tanë Shqipnis, tue tregue se në vend t’onë eksistoj në organizata që zhvillojnë veprim serioze në fushën e përparimit në degë të ndryshme kulturë e arti”.

Çfaqja artistike nisi me marrjen e një cope muzike prej anës s’orkestrës së Shoqnis “Rozafat” dhe, fill mbas kësaj, duel në palko At Gjergj dhe nisi ligjëratën nën heshtjen e plotë të publikut. Përkujtoi, ndër fjalët e tija të thjeshta, kohën e robnis e peripetit dhe andrrat e asaj kohe dhe shënoi shkurtazi veprat e ndryshme q kanë krye ata q u përpoqën për shvillimin e idealeve kombëtare, tue ramë edhe dëshmorë për ta.

Tha se këta ideale i ngjalli e i plazmoi fuqija e fjalës së shkrimtarëve e sidomos të poetenve kombëtarë dhe theksoji se një prej këtyne asht Aleksandër Drenova, ai për të cilin po bahej ajo manifestatë prej anës së popullit shkodranë në shej nderimi dhe evarije. Shoqnis “Rozafat” q kishte organizue kët çfaqje i drejtoj përgëzimet e tija dhe i uroi ditë përherë ma të mira për përparimin të kombit e lumni t’Atdheut e të Fronit. Duertrokitjet, mbas këtyne fjalve, plasën në të katër anët dhe vazhduen për një kohë të gjatë.

Në kët moment, duel në palko Aleksandër Drenova, i cili, i prekun aqë thellë në zemër për çfaqjet q iu drejtojshin, nuk muejti të nxjerrë fjalë prej goje, por përqafi me një thjeshtësi At Gjergjin, përqafje q ju këmbye po me at simplicitet, çka provokoi duertrokitje e entusjasëm aqë të thekshëm në publik sa ishin asish q nuk mbajshin lotët. Ky akt, duem me thanë përqafja e dy vjershtarve në palko, qe me të vërtetë pathetik e i madhnueshëm.

Mbasi mori një copë tjetër orchestra, Ernest Koliqi, duel në palk me një djalë të vogël, të nipin e dëshmorit Zef Harapit, të cilin e paraqiti tue thanë se do të lexonte një vjershë patriotike t’Asdrenit një prej aso vjershash q ngallnuen axhen e tij për të dhanë jetën për atdhe. Leximi i vjershës provokoi duertrokitje tjera të zjarta e të parreshtuna.

Mbrapa mandej vazhdoi eksekutimi i copave t’orkestrës dhe të këndimit të Zojushës Tashko e përcjellun me piano prej Zojushës Aleks.


Zojusha Tashko, sikur dy netë ma parë, tregoi një aftësi të çqueme në këndim dhe zotnimin e njëj zani të pastër dhe të shprehjeve lirike. Artistija e ynë u çfaq në naltësin e hartit të saj sidomos në këndimin e copës së Traviatës, Follie, Follie, të cilën e këndoi plot mjeshtëri e gjallni në fund të koncertit.

Gjithashtu, tregoi zotsi e shkathsi të çqueme në piano Zojusha Aleks. Si sosi koncerti, z. Aleksandër Drenova, falenderoi publikun nga lozha ku kish zanë vend. Edhe ky e drejtoi përsëri duertrokitje dhe çfaqje nderimi ma të përzemërt e të nxehtë. Asdreni po vazhdon të vizitojë institutet kulturele të qytetit t’onë. Trupi i profesorave të gjimnazit shtetnuer e ftoi në drejtorin e shkollës dhe e gostiti me një vermouthe, ku morën në grup edhe një fotografi kujtimi.

LIBRI RI

“TURIST NË UTOPI” UDHËTIME NË PEIZAZHIN SHQIPTAR TË AUTORIT RUNE OTTOSEN

Libri “Turist në Utopi”, ardhur së fundi në shqip, është konceptuar si udhëtime në ideologji dhe në peizazhin shqiptar nga autori norvegjez Rune Ottosen. Ai ka rrëfyer si e njohu Shqipërinë përmes vizitave në vitet ’70. Një libër mjaft interesant i botuar nga shtëpia botuese “Scanderbeg Books”, ku vetë autori Ottosen tregon për udhëtimet e tij si turist politik në kuadër në AKP-së në vitet ’70 dhe për udhëtimet e mëvonshme pas rënies së komunizmit në vitet ’90. Por është gjithashtu një udhëtim në historinë shqiptare, që tregon se si tiparet autoritare nga komunizmi vazhdojnë të mbahen gjallë në Shqipërinë e sotme. Ky libër u promovua pak ditë më parë në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar mes studiuesish, gazetarësh, diplomatësh dhe dashamirës. Gjithashtu, Muzeu Historik Kombëtar dhe “Skanderbeg Books” organizuan bisedën me temë “*Turist në Utopi* dhe e vërteta e terrorit komunist shqiptar”, e udhëhequr nga shkrimtarja Flutura Açka, për të folur mbi këtë temë ishte një panel i zgjedhur, i përbërë nga: prof. dr. Agron Tufa; dr. Dorian Koçi, drejtor i Muzeut Historik Kombëtar; si dhe autori i librit, Rune Ottosen.



Autori i librit, Rune Ottosen, u shpreh: “Shqipëria është një vend i veçantë dhe me një histori të veçantë. Praktika e shkrimit të këtij libri, para së gjithash, është gazetari. Kam bërë disa intervista me ish-të burgosur politikë, por kam folur edhe me njerëz të takuar rastësisht dhe u kam marr leje të pasqyroj historitë e tyre. Thua se çdokush që takon në Shqipëri, ka një histori për të treguar, dhe të gjithë bashkë rrëfejnë se Shqipëria ka qenë një diktaturë e tmerrshme dhe mizore.”

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi, u shpreh në fjalën e tij: “Ky libër na risjell në memorien tonë njëherazi kujtesën dhe lirinë, jetën e shqiptarëve nën regjimin diktatorial. Të gjithë ne kemi detyrën morale të hedhim dritë mbi atë terr të kalvarit të vuajtjeve që shoqëruan jetën e shqiptarëve, të cilët pa asnjë provë shpallëshin fajtorë dhe sa hap e mbyll sytë, ktheheshin në armiq të popullit.” Prof. dr. Agron Tufa u shpreh: “Libri i cili na ka mbledhur sot është një udhëtim jo vetëm i autorit, por shumëplanesh, i cili na mobilizon që edhe ne të bëjmë udhëtimin tonë në Shqipërinë e viteve ’70. Është një libër në të cilin mund ta gjejmë veten protagonist, një regjim i pandërprerë terrori shumëplanesh.”

JORGOS SEFERIS, POEZIA E DHIMBJES

nga Romeo Çollaku



Në maj të vitit 1931, u shfaq në raftet e librarive të Athinës një përmbledhje e imët poetike, me dyzet e një faqe, me katërbëdhjetë poezi gjithë-gjithë, pjesa më e madhe e të cilave, për sa i përket vargëzimit, llojeve të rimës e të metrikës, nuk është se dallonte edhe aq nga gjedhet e njohura të kohës. Ballinë e thjeshtë: emri, pothuajse krejt i palakuar deri atëherë, i poetit dhe titulli, mirëpo ky – një enigmë. Një fjalë e vetme, sa e zakonshme aq edhe pësjtjelluese në këtë rast, një fjalë e dykuptimtë, që do të thoshte njëherësh edhe *strofë*, por edhe *kthesë*. Kuptimi i parë mund t’u kujtonte lexuesve të thekur të poezisë titullin e atij librit aq të përmendur të një bashkëqytetari të tyre të dikurshëm, që hiri i prehej tanimë në *Père-Lachaise*: “Stances” e Jean Moréas-it. I dyti do t’i ndriçohej, gjithnjë e më shumë, me kalimin e viteve, kur të dëshmohej se përmbledhja në fjalë paskësh shënuar me të vërtetë një kthesë të spikatur në rrugën e poezisë së re greke.

Veshi, deri diku, u ishte stërvitur me muzikën e atyre vargjeve, pesëmbëdhjetërokëshi tradicional grek i poemës “Ligjërime dashuror” nuk ishte i huaj për askënd prej tyre, por qenë shtangur, ndërkaq, në një gjendje hutimi jashtë portës së mbyllur të kumteve. Gjer dhe plaku mendjemprehtë Kostas Palamas, përpara dijeve letrare të të cilit përkuleshin me nderim gjithë shkrimtarët e Greqisë, do të shprehej: “Poezitë e *Kthesës* janë kriptografike. U duhet një çelës. Nuk e shoh gjëkund. Bëj pjesë ndër ata njerëz që kanë nevojë për çelës.” Disa nga kritikët më në zë ose i mohuan tërësisht, duke i quajtur si të padenja, ose u vunë në siklet përballë atyre poezive, duke i cilësuar shkurt si surrealistë, në një kohë kur poeti, megjithëse lëvizja e surrealizmit po përjetonte kulmin e lulëzimit, kishte qëndruar ftohtë kundrejt prurjes poetike të saj dhe do të mbetej mosbesuese edhe në të ardhmen.


Nuk bëhej shumë kohë që autori i librit, Jorgos Seferis, që kthyer nga Parisi dhe, gjatë viteve të atjeshme studentore, ishin krejt të një natyre tjetër fizionomitë që i patën tërhequr vëmendjen: Jules Laforgue dhe Valéry i “Varrezës detare” e i “Zotit Test”, fryma e të cilëve vërehet përkorazi në këtë periudhë të parë të krijimtarisë së tij, por, me sa duket, jo më pak edhe Paul Claudel, ndikimi i frymëmarrjes së thellë të versetit të të cilit, pavarësisht se nuk i është mëshuar, për mendimin tim, mjaftueshëm nga studiuesit, do të vazhdojë të ndihet deri vonë në veprën e Seferisit, deri në vitet ‘50.

Teksa kritikët përshëndetëse ndaj “*Kthesës*” numëroheshin me gishtat e dorës, pasoi, mbas një viti e ca, në tetor 1932, “*Sterra*”, një poemë kjo me varg të matur, por me rima të çrregullta, me asonanca e konsonanca, me pika heshtjeje, si dhe me një simbolikë po aq të fshehtë e në kufijtë e së padeshifrueshmës, që e rrëmojnë edhe sot e kësaj dite, duke i dhënë secili nga një interpretim të vetin dhe duke pikasur pas alegorisë së sterrës kush jetën, kush të kundërtën e saj e kush një histori dashurie të rinisë së hershme.

Poeti, për të cilin sapo kishte filluar një odise tridhjetëvjeçare vërtitjesh nëpër botë, në shërbim të diplomacisë së vendit të tij, ndodhej ndërkohë në Angli, në atë vend “që nuk reshti kurrë së qeni ishull”, siç e quajti ai asokohe dhe ne sot habitemi e bindemi për vërtetësinë e plotë të këtyre fjalëve, tek i shohim pasardhësit e Shakespeare-it të zgjedhin vullnetarisht shkëputjen prej vëllazërisë europiane. Ishte vendosur me punë në Londër, ku, duke e mësuar anglishten me ndihmën e teksteve të dramaturgut elisabetian, po zbulonte, pas së parës, francezes, edhe një punishte të dytë, atë të mjeshtërive anglosaksonë. Po njëjtte, pra, Pound-in dhe Eliot-in, që, sa me ato poemat e mëdha, aq edhe me mësimet e paçmueshëm të eseistikës së tyre, do t’ia zgjeronte edhe më tej horizontin dhe do të luanin, sidomos i dyti, një rol vendimtar në formimin e mëtejshëm të tij.

Qysh prej këtij çasti, ritmi i poezisë së Seferisit nis të ndryshojë, rrjedhshmëria melodike i shndërrohet në një tjetër rrjedhshmëri, më të ndërlikuar dhe më autentike, në një sintaksë gjithnjë e më jokonvencionale, herë të shtruar e herë me thyerje të befta, me ngërçe të qëllimshme e me përsëritje, ndërsa toni i zërit të poetit fillon e merr nota më rrëfimore, nota të theksuara dramaciteti, diku edhe tragjizmi, duke u bërë më i rëndë, sepse mjaft e rëndë edhe pesha e temave që do të trajtojë këtej e tutje. Dhe, ashtu si përmbledhja e tij e parë përbënte një kthesë në mbarë poezinë e Greqisë së Re, mund të themi se poema sintetike “*Legjendat*”, e botuar më 1935, na paraqitet si një kthesë, edhe kjo, porse në udhëtimin vetjak, në zhvillimin e këtij personaliteti krijues. Veçoritë e reja që i shtohen ligjëritit të tij, sikurse i vumë në pah, bien menjëherë në sy te kjo vepër e organizuar në njëzet e katër pjesë, sipas shembullit të dy eposeve homerike.

Viti i botimit të “*Legjendave*”, falë edhe një serie



“

Nuk bëhej shumë kohë që autori i librit, Jorgos Seferis, që kthyer nga Parisi dhe, gjatë viteve të atjeshme studentore, ishin krejt të një natyre tjetër fizionomitë që i patën tërhequr vëmendjen: Jules Laforgue dhe Valéry i “Varrezës detare” e i “Zotit Test”


ngjarjesh të tjera që e shoqëruan, shquhet sot, me atë begati të pashoqe, si një kapërcyell i vërtetë, si një Pashkë, një stinë rënieje dhe ngjalljeje e një poezie të lartë, siç është poezia greke e shekullit XX. Pra, në këtë vit, kur një tekë e rastësisë e deshi që Palamasi, i mbiquajtur patriark i Greqisë shpirtërore pothuajse për një pesëdhjetëvjeçar të tërë, të botonte librin e lamtumirës, Odisas Elitisi, duke u dorëzuar më në fund përpara këmbënguljes drobitëse të Seferisit, do t'i nxirrte disa prej vargjeve të tij nga sirtarët, për të debutuar me një cikël poetik. Po më 1935, bashkëmoshatare i këtyre, Andreas Empirikos, përveçse botoi një nga punët më të vlerata të tij në poezi, "Furnaltën", mbajti në Athinë, para një auditori të gjerë shkrimtarësh, intelektualësh e lexuesish, një kumtesë me rëndësi historike rreth surrealizmit dhe rreth ndodhive më të freskëta në letër, por edhe në psikanalizë e në fusha të tjera të mendimit. Gjithashtu, poetë, si Sarandaris, Ricos e Vretakos, botuan përmbledhjet e radhës, me poezi që, tashmë, janë bërë antologjike dhe me vargje ende të paharrueshme. Qysh në janar kishte qarkulluar numri i parë i revistës *Ta Nea Grammata*, rreth së cilës u mblodhën penat më të zgjedhura të këtij brezi të artë të letërsisë greke, që do të përmendej më pas si brezi i viteve '30.

Kuadri historik, skena e përgjithshme mbi të cilën u shfaq ky brez, dallohet si një nga pikat më kyçe të helenizmit. Përpjekjet njëshekullore të grekëve, të filluara këto qysh prej kryengritjes për liri e pavarësi të vitit 1821, me synim përfshirjen në një shtet të vetëm të gjithë trojeve ku flitej greqishtja, u ndërpre në pakurorëzuar pas mbarimit të luftës greko-turke të viteve 1919-1922. Qendrave të lavdishme të lashtësisë, Athinës, Spartës dhe krahinës së Maqedonisë, nuk iu bashkua dot edhe kryeqendra e Bizantit, që, bashkë me vendlindjen e Seferisit dhe me gjithë pjesën bregdetare të Azisë së Vogël, mbeti përfundimisht jashtë. Pas marrëveshjes së Lozanës, më të shumtët e shtetasve turq të besimit të krishterë, mbi një milion e gjysmë shpirtira, u detyruan t'i braktisnin vatrat e të parëve, për t'u shpërngulur në Greqi. Mes këtyre të çrrënjosurve numërohet edhe Jorgos Seferisi, i cili, që nga ai çast, vetëm si vizitor mund t'i shkelte sërish viset ku u lind dhe kaloi fëmijërinë, një plagë ngaherë e mahisur kjo për të, ndaj "kujtesa, - do të thoshte më vonë, - kudo që ta prekësh dhemb".

Dalja prej një fatkeqësie të tillë diktonte riorganizim forcash, përsiatje të kthjellët, rishikim të një trashëgimie, që ngjante, krahasimisht me popuj të tjerë, e paanë. Përkushtimi kryesor i Seferisit me shokë ishte ndriçimi i vlerave greke, i stacioneve të çdo epoke, në mënyrë që të bëhej e rrokshme dhe e prekshme ajo vijueshmëri prej gati tri mijë vjetësh. Dhe, afërmendsh, llogaritë më të koklavitura nuk mund të ishin tjetër veçse me periudhën më të ndritur, me rrënojat e tempujve dhe shtatoreve të antikitetit. Me bërthamën e asaj që emërtohet ndërgjegje kombëtare.

Shenja e parë e kësaj sipërmarrjeje vigane të brezit në fjalë u dha, pikërisht, nga "Legjendat", një poemë kjo më pak e *errët* se dy librat e parë të poetit, e pajisur me kode më të lexueshme, me disa nga çelësat që pati kërkuar Palamasi. Çelësa të llojit: "U zgjova me këtë kokë mermeri në duar/ që po m'i rraskapit bërrylat dhe nuk di ku t'i mbështes." Te kjo poemë, pra, vërehet, mbase jo për herë të parë, por pa dyshim që më qartazi, një ndër shqetësimet themelore të Seferisit, i cili, në vazhdim, do t'ia përshkojë gjithë veprën. Ndjenja e përgjegjësisë. I ndodhur përpara një tradite që paskësh qëlluar të ishte një prej thesareve më të vyera të njerëzimit, Seferisi nuk e ka mendjelehtësinë t'i gëzohet, të krekoset me të, por e kaplon një stepje. E mundojnë pyetje: A e mbajnë dot duart tona, të grekëve të sotëm në radhë të parë, por, më gjerë, edhe të qytetërimit të sotëm perëndimor, një barrë kaq të rëndë? Sa e meritojmë? Sa jemi në gjendje të përfitojmë prej një testamenti të tillë?

Dhe përgjigjja që i përvidhet prej thellësive të ankthit, pasi vëzhgon një e më dy rreth e qark, është, në rastin më të mirë, në rastin më kurajues, dyshimi.



“

Poeti, për të cilin sapo kishte filluar një odise tridhjetëvjeçare vërtitjesh nëpër botë, në shërbim të diplomacisë së vendit të tij, ndodhej ndërkohë në Angli, në atë vend “që nuk reshti kurrë së qeni ishull”, siç e quajti ai asokohe dhe ne sot habitemi e bindemi për vërtetësinë e plotë të këtyre fjalëve...

"Mbytet kush ngre gurët e mëdhenj", - do të shprehet te "Gymnopedia"; pastaj "na zuri gjumi na morën për të vdekur" te "Fletore ushtrimesh"; dhe këtë kanosje të fatit ka për ta ndier e për ta theksuar - si gjasa më rrëqethëse që i kalon, me sa duket, nëpër mend - hap pas hapi, deri në fund.

Duhet të ketë qenë kjo ndjenjë e mundimshme përgjegjësie që i priu Seferisit, qysh në fillime, drejt përdorimit të vetës së parë të shumësit, të cilën e ndeshim kaq dendur në poezinë e tij. Ngritja e barrës së traditës shumëshekullore mund të arrihej vetëm me ndërgjegjësimin dhe me pjesëmarrjen e të gjithëve.

Seferisi është, pra, nga ata poetë që, ndonjëherë, kur lypset t'i thjeshtëzojmë gjërat, i quajmë poetë të mendimit, mirëpo, në ndryshim prej disa shembujsh të tjerë të këtij lloji, që, për sa u përket manierave, na paraqiten të njëtrajtshëm apo të ngushtë, ai ishte çdo çast në kërkim të mënyrës më të saktë të të shprehurit, ishte tejçues i një mendimi të thellë, por edhe të stërpikur çdo çast me lirizëm. Dhe le të kujtojmë përsëri se, që në krye të herës, ajo ç'interesoonte më shumë ishte forma. Ngashënjimi i formës, me magjinë e me mundësitë që di të premtojë, pati qenë pika nga u nis dhe shohim se vëmendja ndaj saj nuk i venitet ndonjëherë, as kur lëvron vargun e bardhë dhe kundruar për së jashtmi, të lirë. Tekefundit, basti kryesor, jo vetëm i atij, por edhe i gjithë brezit ku përfshihet si figurë qendrore, ishte zbatimi në traditën greke i mësimëve që dilnin prej veprave të modernizmit europian. Dhe, duke qenë se "fjalët tona janë fëmijët e shumë njerëzve" sikundër lexojmë tek "Tri poezitë e fshehta", ndikimi, vërtet i dukshëm, në poezinë e Seferisit prej simbolistëve të vonë francezë e, në veçanti, prej ligjërimit eliotian, dëfton më së miri se ndikimet e frytshme, me të cilat është bekuar rruga e letërsisë, ndodhin atje ku gjejnë një prirje të mëparshme, sepse nuk janë gjë tjetër veçse fara që mbijnë vetëm në truallin e përshtatshëm. I këtillë, i frytshëm dhe i fuqishëm dhe ende i paplatitur, do të ishte edhe ndikimi i zërit të vetë Seferisit mbi gjithë poezinë e mëpastajshme greke, por edhe te poetë


gjuhësh të ashtuquajtur të mëdhenj, siç janë, fjala vjen, frëngjishtshkruesit Bonnefoy dhe Jaccottet.

Pak a shumë, këto - udhëtimi në kohë i trashëgimive letrare greke dhe europiane, pemët më të larta gjenealogjike të tyre, ballafaqimet dhe marrëdhëniet e ndërsjellta midis njërit poet dhe tjetrit, midis njërit letërsi dhe tjetres, vërtetet dhe vështirësitë e poezisë së re, por edhe të arteve të tjera, peripecitë dhe pengesat shpesh të pashmangshme gjuhësore - janë edhe çështjet që fllon në veprën e tij të pasur eseistike, e cila sot është shndërruar në një doracak tejet të dobishëm për këdo që, si krijues apo si lexues, ndien nevojën e një harte nëpër rrugët e metaforës. Edhe tek esetë, shohim po atë vetëpërmbajtje dhe maturi, po atë ndjenjë mase dhe saktësie që syri i kujdesshëm i vëren në poezinë e tij dhe që disa mendojnë se ia kaliti puna e diplomatit, teksa ka gjasë të jetë edhe e kundërta: t'i jenë mëkuar nga leximet e pareshtura të tragjikëve e të filozofëve të lashtë, si Herakliti, dhe, pastaj, t'ua ketë përcjellë edhe letërsisë e, pse jo, diplomacisë që ushtroi gjatë gjithë jetës.

Për sa i përket fushës tjetër të veprimtarisë letrare të tij, përkthimit, kesi frytsh, merret vesh, u takojnë vetëm rrethojave të gjuhës përkatëse ku mbartet çdo tekst, prandaj le të mjaftohemi me shënimin se edhe këtu ndihmesa e Seferisit ishte e çmuar, duke qenë ndër të parët që i njohu bashkatdhetarët e vet me disa nga arritjet më madhore të poezisë, siç janë "Toka e shkretë", "Kantot", "Udhëtim në Bizant" apo "Një mbrëmje me z. Test".

Në shoqërinë e këtyre veprave, e prurjeve më të mira të atij që mund ta quanim modernizmi themelor, qëndron edhe poezia e Jorgos Seferisit, me të vetmen *mangësi* të pafajshme dhe të pamënjatueshme se u gdhend mbi mermerin e një gjuhe "të përmendur në shekuj, por të kufizuar në trajtën e sotme të saj".

Parathënie e librit të Jorgos Seferis, "Poezi", përkthyer nga Romeo Çollaku dhe Alket Çani, botimet "Pika pa sipërfaqe", Tiranë, 2019.



THANAS
MEDI

Kohë
e djegur

Onufri Roman